



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS DHE SHKENCAVE HUMANE

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM PËR PROGRAMET E STUDIMIT QË OFROHEN NGA FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE DHE SHKENCAVE HUMANE

GRUPI I NJSBC (GVB)

EMËR MBIEMËR

Dr. Maria Dojçe
Msc. Lorena Kelo
Msc. Blendi Baze
Dr. Desareda Mero
Katerina Sotir

Departamenti i Shkencave Sociale
Departamenti i Matematikës, Informatikës, Fizikës
Departamenti i Infermierisë
Departamenti i Biologji-Kimisë
Studente

VITI AKADEMIK 2019-2020

Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm

I. PARIMET E PUNËS SË GVB

- Vlerësimi i Cilësisë karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njesisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve.
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë si referencë për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Raporti i vlerësimit të brendshëm të përmbajë të dhëna objektive të bazuara në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

II. ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA IAL

1. Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASAAL dhe Bordi i Akreditimit;
2. Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA;
3. Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
4. Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit;
5. Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkesë;
6. Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit;

7. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve në këtë udhëzues dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë;
8. Dorëzimi në ASCAL i RVB, (në rastin kur ky proces kryhet si pjesë e vlerësimit dhe akreditimit periodik);

III. DOSJA E VETËVLERËSIMIT

Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit përfshihet: *Mendimi me shkrim i Drejtuesit të Njesisë dhe Raporti i Vlerësimit të Brendshëm*, i shkruar nga GVB

Kërkohet mendimi i drejtuesit të Njesisë, kur Program/et e studimit po kalonjnë fazën e rivlerësimit periodik. Në këtë rast ai do të shkruajë:

- Të dhëna për Institucionin e Arsimit të Lartë që ai drejton
- Të japë opinionet e veta personale ku të tregohen vlerat e forta, dobësitë dhe perspektiva e programeve të studimit për të cilën është përgjegjës;
- Të analizojë zhvillimet kryesore që nga vlerësimi i fundit, duke theksuar sidomos përmbushjen e detyrave të lëna nga vlerësimet e mëparshme;
- Të tregojë gjendjen ekzistuese në raport me atë programi/et e studimit, ka për mision ose synon të arrijë.

Raporti Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë vlerësimin e GVB për këto çështje:

A) PROGRAMET E STUDIMIT, MISIONI, ADMINISTRIMI

B) POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

C) KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT

RVB përbëhet nga *11 Rubrika kryesore*. Çdo rubrikë që kërkohet të analizohet përbëhet nga tre pjesë:

- ❖ Pjesa përshkimore
- ❖ Pjesa e treguesve të matshëm (Tabelat, shoqëruar me Anekset).
- ❖ Vlerësimi sipas Standardeve

Në pjesën përshkimore, GVB sipas termave të referencës përshkruan aspektin përkatës të vlerësimit. Në pjesën e treguesve të matshëm GVB do të japë të dhëna sasiore, tabela etj, të cilat vërtetojnë përfundimet e pjesës përshkimore. Ndërsa në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve GVB do të përgjigjet konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo.

RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Për Programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i

Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane

Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë

HYRJE

Ky raport prezanton rezultatet e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të ciklit të parë të studimit “Bachelor” dhe programeve të ciklit të dytë “Master” të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë, kryer nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm.

Qëllimi i këtij procesi është që të sigurojë një vlerësim korrekt, të bazuar në tregues realë dhe të matshëm të nivelit të arritjes së standardeve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit të përfshirë në vlerësim, të përgatisë një raport i cili do të shërbejë si bazë për grupin e vlerësimit të jashtëm, gjatë procesit të akreditimit. Për të përmbushur me sukses këtë qëllim, GVB është bërë pjesë e trajnimeve paraprake të organizuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Universitetit, mbi bazën e përvojës së vlerësimeve të mëparshme, duke hartuar edhe një plan pune, duke ndarë detyrat dhe duke udhëzuar GVB për përmbushjen e detyrave. Për hartimin e këtij raporti, GVB mbajti parasysh edhe raportin e GVJ që u realizua në kuadër të akreditimit institucional

Gjithashtu u shfytëzuan të gjitha materialet, të dhënat e Fakultetit, vlerësimet e kryera nga studentët për procesin mësimor, për stafin akademik, për infrastrukturën. Dokumentacioni bazë, mbi të cilin u mbështet procesi i Vlerësimit të Brendshëm në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane:

- Ligj nr. 80/2015, për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë
- Standardet shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve
- Raporti i Vlerësimit Institucional i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë qershor 2019
- Analiza e punës mësimore–shkencore 2019-2020 për Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane
- Udhëzimet e MASR-së
- Dokumente të veprimtarisë institucionale të Universitetit “Fan S. Noli”, më konkretisht:
 - Statuti i UK-së,
 - Rregullore e UK-së,
 - Rregulloret e Programeve të studimit
 - Rregullore e transferimeve
 - Rregullore ESSE3
 - Planet mësimore
 - Formularët e ngarkesës vjetore të stafit

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Maria Dojçe	Departamenti i Shkencave Sociale	Staf akademik
Blendi Baze	Departamenti i Infermierisë	Staf akademik
Blerina Çeliku	Departamenti i Matematikës, Fizikës	Staf akademik
	Departamenti i Teknologji	
	Informacioni	
Desareda Mero	Departamenti i Biologji-Kimisë	Staf akademik
Katerina Sotir	Departamenti i Teknologji	Student
	Informacioni	

PROGRAMET E STUDIMEVE, MISIONI, ADMINISTRIMI

Skeda Informative

Fakulteti	Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane	
Adresa:	Rr. "Nënë Tereza", L. 2	
Email:	dekanati@yahoo.com	
Licencuar:	Vendimi nr. 5, datë 7 janar 1992. Licencuar si Fakulteti i Mësuesisë	
Statusi aktual ligjor:	Urdhër nr. 16, datë 17.1.2012. Emërtuar: "Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane"	
Përfaqësuesi zyrtar:	Prof. dr. Gjergji Pendavinji Tel. : ++ 355 822 43300 e-mail: gpendavinji@unkorce.edu.al	Dekan i Fakultetit
	Prof. dr. Lorenc Ekonomi Tel. : e-mail: lekonomi@unkorce.edu.al Dr. Lorena Margo Tel.: +355692504130 e-mail: lmargo@unkorce.edu.al	Zv.Dekan i Fakultetit
Struktura Akademike:	Departamenti i Shkencave Sociale Departamenti i Infermierisë Departamenti i Matematikë-Fizikës, Departamenti i Teknologji Informacionit Departamenti i Informatikës Departamenti i Biologji-Kimisë	
Oferta Akademike:	Program profesional 2-vjeçar pas arsimit të mesëm (Niveli 5 KSHK) Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor) (Niveli 6 KSHK) Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencave, Master Profesional) (Niveli 7 KSHK)	

1. Misioni dhe Objektivat e programeve të studimit

Pjesa përshkimore

Universiteti "Fan S. Noli" Korçë në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal; të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor , si dhe të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. Siç dihet, Rajoni i Korçës është i njohur për traditat arsimdashëse dhe nevojat që ka ai për

mësimdhënës të disiplinave të ndryshme. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka në përbërje të tij tre Departamente, dhe dy grupe mësimore - kërkimore: një grup mësimor - kërkimor të atashuar në Departamentin e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës si dhe një grup mësimor kërkimor të atashuar në Departamentin e Infermierisë.

Fakulteti ka një bashkëpunim shumë të frytshëm me disa fakultete homologe në Rajon dhe në Europë. Përmendim këtu Universitetin Kirili e Metodi, Maqedoni; Universitetin Aristoteli, Selanik, Greqi; Universitetin e Prishtinës; Universitetin e Sofies, Bullgari etj. Në këto Universitete, pedagogë të ndryshëm kanë realizuar kualifikime afatshkurtra dhe afatgjata, duke përfutur nga eksperiencia e tyre. Ndërkohë, disa studentë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, kanë realizuar dhe punimet e diplomave të tyre në këto Universitete.

Të gjitha këto janë kyçi i suksesit tonë në përgatitjen e profesionistëve në fushën e Sociologjisë, mësuesve profesionistë të Filozofisë dhe Sociologjisë, të Matematikës dhe Fizikës, të Biologji - Kimisë, profesionistëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Infermierëve të përgjithshëm dhe Mami, të një niveli të lartë shkencor, me dije bashkëkohore dhe me mundësi punësimi shumë të larta.

Reforma më e madhe arsimore e kryer së fundmi është strukturimi i programeve të studimit në përputhje me parimet e hedhura në Deklaratën e Bolonjës dhe në të gjitha dokumentat e tjera pasuese, të cilat gjejnë pasqyrimin e tyre në Ligjin Nr.9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në amendamentet e pasqyruara në ligjin Nr.10307, datë 22.07.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9741”, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Kështu sot në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, arsimimi i lartë është i organizuar në dy cikle, duke ofruar dy nivele diplomash; lëndët janë të organizuara në module dhe ngarkesa e tyre shprehet në kredite; programet e studimit janë të gjitha bashkëkohore. Ato ndjekin programet e studimit të fakulteteve homologe, kryesisht të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Fakultetit të Shkencave Sociale, në Universitetin e Tiranës, por edhe të Rajonit. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diploma përkatëse dhe suplementin e diplomës; studentët kanë mundësinë e transferimit të krediteve nga një Institucion tjetër i Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe të pajisen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për tu larguar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane në një IAL tjetër.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka pësuar përmirësime dhe zhvillim edhe në drejtimin institucional, duke u organizuar mbi bazën e Departamenteve dhe funksionimin e organeve kolegjiale në vendimmarrje. Kështu në Fakultet funksionon normalisht Këshilli i Fakultetit, i cili është organ kolegjial vendimmarrës. Mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, shkalla e gjerë dhe e balancuar e përfaqësimit, funksionet që kryen dhe autoriteti vendimmarrës të shprehura në Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren e brendshme të Fakultetit garantojnë një autonomi të brendshme institucionale në menaxhimin e Fakultetit dhe të njësisë të tij bazë.

Në Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është shtuar dhe Qendra e Ekselencës, Mbështetur në udhëzimet e MASH, Urdhër nr. 110, dt. 09.03.2011 për: “Nevojat për Trajnimin e Mësuesve dhe Drejtuesve të Arsimit Parauniversitar”, e cila përbën një njësi bazë, kërkimore dhe

trajnuese. Kjo qendër ka si mision të vetin, formimin cilësor të specialistëve në fushat përkatëse dhe promovimin e kërkimit shkencor në shkencat e natyrës dhe ato humane. Ajo funksionon si njësi trajnuese dhe kërkimore në fushën e Didaktikës së Shkencave, e certifikuar dhe akredituar nga MASH.

Krahas përqëndrimit të veprimtarisë kërkimore të Fakultetit, Qendra e Ekselencës zhvillon një aktivitet të gjerë trajnues duke ofruar programe për mësuesit në shërbim në Rajonin e Korçës dhe më gjerë, në fushat:

- a. Drejtim dhe administrim i shkollës;
- b. Shkenca sociale: Filozofi, Sociologji;
- c. Shkencat natyrore: Matematikë, Fizikë, Informatikë, Biologji, Kimi,

Këto programe trajnimi synojnë zhvillimin e shprehive në mësimdhënie, të praktikave mësimore, si dhe të aftësive të drejtimit për personelin në detyrë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ka patur një dinamikë të lartë zhvillimi në vitet e fundit: në drejtim të zhvillimit të programeve në të dy ciklet e studimit, duke krijuar programe krejtësisht të reja dhe rikompozim të përgjithshëm, të kujdesshëm të atyre ekzistuese në përputhje me kërkesat e reformës së Bolonjës dhe në drejtim të rritjes së numrit të studentëve, rritjes së stafit akademik në numër dhe në kualifikim dhe të atij ndihmës.

Synimet e programeve të studimit

Objektivat e përgjithshme:

Objektivat e programeve të studimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane janë në vijimësi dhe mbështetje të qëllimit dhe objektivave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane dhe Universitetit Fan S Noli, Korçë. Me konkretisht për vitin akademik 2019-2020 ka synuar këto objektiva:

Të sigurojë ecurinë dhe zhvillimin e programeve të studimit të licensuara të të gjithë departamenteve të këtij fakulteti.

- Për vitin akademik 2019-2020 në Departamentin e Shkencave Sociale u zhvilluan: 2 programe të ciklit të parë Bachelor dhe 2 programe studimi Master Profesional.
- Në këtë vit përfundon me sukses cikli i programit 2-vjeçar “Shërbim Social” duke mundësuar dhe vazhdimësinë për studentët e këtij programi.
- Departamenti i Biologji Kimisë zhvilloi me sukses mësimin në dy programe studimi: 1 program Bachelor dhe 1 program Master në mësuesi.
- Departamenti i Matematikë Fizikës, realizoi me sukses mësimin në 2 programe studimi të nivelit Bachelor dhe 1 program studimi Master në mësuesi.
- Departamenti i Teknologji Informacioni realizoi me sukses mësimin në 1 program Bachelor dhe 1 program Master Profesional.
- Departamenti i Infermierisë realizoi me sukses mësimin në 2 programe Bachelor dhe 1 program Master Profesional.

- **Ndër objektivat kryesore të këtij viti akademik kanë qënë:**
- **Të sigurojë plotësimin e kuotave të propozuara për të gjitha programet e studimit dhe të përmirësojë cilësinë e kandidatëve aplikues dhe fitues**

Nëpërmjet promovimit të programeve të studimit, që diplomojnë studentë me kompetenca për tregun e punës.

Nëpërmjet krijimit të një ambienti pune, dhe kërkimi shkencor, ku theksohet bashkëpunimi mes kolegëve, dhe përshtirja e studentëve në aktivitetet e tjera promovuese të departamenteve. Konkretisht në këtë vit 2019-2020 shënojmë rritje të mesatares së përgjithshme të studentëve në programet bachelor, krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Në këtë vit u shënuar një ulje në numrin e kandidatëve të regjistruar sidomos kjo në programin e studimit bachelor: Filozofi – Sociologji.

Në programet e tjera plotësimi i kuotave është më i stabilizuar.

Të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies duke e vlerësuar si një element shumë të rëndësishëm të ecursisë së programeve dhe rezultateve të studentëve.

Konkretisht në kuadër të sigurimit të kurrikulave cilësore në programet e studimit të ciklit të parë bachelor, dhe të programeve master profesional dhe master shkencor, realizoi:

- Rishikim të kurrikulës dhe të çdo lënde dhe moduli për të qënë sa më koherentë me zhvillimet, dijen e re dhe literaturën aktuale. Kjo për të pajisur studentët me dije të qëndrueshme dhe kompetitive.
- U rishikuan struktura e ndërtimit të lëndëve dhe moduleve në këto programe studimi në shërbim të pajisjes së studentëve me kompetenca shkencore dhe profesionale
- U synua nxitja e mendimit kritik dhe përgjegjshmërisë qytetare tek studentët për të bërë universitetin një institucion demokratik të arsimit. Përfshirja e studentëve në aktivitete të përbashkëta (seminare shkencore), dhe nxitja për funksionimin e debateve në grupe etj.
- Përgjatë vitit akademik 2019-2020 departamenti i Shkencave Sociale po punon për hartimin dhe aplikimin e programeve të përbashkëta me universitete rajonale duke synuar afrimin e disiplinave ndërfunksionale duke i gërshtuar ato me njëra tjetrën, për t'i afruar me tregun e punës, studentin dhe pedagogun.
- Gjithashtu, departamenti i Shkencave Sociale hartoi gjatë këtij viti akademik strategji të reja për vazhdimësinë e programit Master Shkencor në “Filozofi Sociale” për vitin 2019-2020.

Të nxitë kërkimin shkencor dhe kooperimin në fusha të përbashkëta kërkimi në departamente

Aktiviteti shkencor në departamentet e FSHNH ka theksuar këto fusha të përbashkëta studimi: Mësimdhënia bashkëkohore dhe teknologjia, filozofia për fëmijë, administrim dhe menaxhim i institucioneve të edukimit, praktika institucionale dhe empirike në fushën e Biologji-Kimisë, mësimdhënia e integruar në shkencat natyrore.

- Gjatë vitit akademik 2019-2020 departamenti i Shkencave Sociale mori në konsideratë shqyrtimin e domosdoshmërisë së një programi studimi “Mësimdhënia bashkëkohore dhe teknologjia” i cili u vlerësua nga anëtarët e departamentit si një fushë e përbashkët interesi dhe nevojë në shërbim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, në shërbim të projekteve për përgatitje dhe publikime të teksteve për studentët etj.
- Filozofia për fëmijë, është pjesë e studimeve dhe kërkimit shkencor për një pjesë të rëndësishme të departamentit duke qënë shpesh dhe qendër referimesh në simpoziume, seminare dhe aktivitetet shkencore të departamentit dhe fakultetit.
- Po kështu dhe fusha e administrimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore po përqëndron diskutimin si një fushë me interes për pedagogë dhe studentë të programeve master në departament.

Kualifikim i mëtijshëm i stafit akademik të departamenteve

Motivim dhe nxitje drejt mbrojtjes së gradës doktor për të gjithë doktorantët dhe regjistrim në shkollën e doktoraturës të asistent pedagogëve të departamenteve.

- Organizimin e aktiviteteve shkencore, nga departamente, në fushën e Mësimdhënies bashkëkohore dhe teknologjisë, Teknologjia dhe inovacioni, infermieristika, matematika, fizika, teknologjia dhe inovacioni, biologjia dhe kimia.
- Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Viti 2019-2020 është karakterizuar nga një sërë aktiviteteve akademike. Konkretisht, janë mbajtur 5 orë të hapura për studentë dhe pedagogë, 2 konferenca shkencore dhe 1 botim.
- Gjatë vitit akademik 2019-2020, departamenti i Shkencave Sociale në bashkëpunim me Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë në Tiranë, dhe Fondacionin gjerman KAS organizuan shkollën verore me temë “*Të jetosh në kufij*”. Në këtë shkollë verore morën pjesë 20 studentë të FSHNH të cilët në fund të kësaj shkolle u certifikuan për realizimin e punës në terren dhe finalizimin e suksesshëm të këtij projekti.

Studimi i tregut qëndron gjithmonë në fokus të punës së departamenteve të FSHNH, për të qënë në gjendje për të lexuar kërkesat e tregut dhe shoqërisë, drejtuar universitetit.

Mbetet sërisht një çështje e hapur dhe e domosdoshme për t`u zhvillur dhe thelluar edhe në vitet në vazhdim. Kjo do të pasojë dhe me hartimin dhe propozimin për hapjen e programeve të reja të studimit në përgjigje të nevojës dhe kërkesës së tregut.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit; Kriteri 4 Programet e studimit kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programeve; Kriteri 5 Programet e studimit hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 6 Programet e studimit hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.	Në rregulloret e programeve të studimit për secilin program përcaktohet qartë qëllimi dhe misioni i programit të studimit.^{1;2} Gjithashtu përcaktohen edhe objektivat³, si dhe elementet që lidhen me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit⁴
Standardi 1.2 - Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimit janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit; Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme; Kriteri 3 Programet e studimit synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;	Programet përputhen më së miri me fushat strategjike të strategjisë së zhvillimit të institucionit.⁵ Fushat e studimit për këto programe, përkojnë me drejtimit e kërkimit shkencor në UNIKO⁶. Programet e studimit synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;^{7;8}
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II.1 - Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimit synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e	Programet e studimit që ofrohen në FSHNH si ofertë akademike, plotësojnë kërkesat e maturantëve për të vazhduar studimet në këto drejtime dhe vlerësimi të stafit drejtues për nevojën e plotësimit të ofertës së institucionit me programe në këto fusha studimi që çojnë kryesisht në profesionin e mësuesisë sipas kritereve të LPAL⁹. Aktiviteti I FSHNH-së në kuadrin e UNIKO-s si institucion i arsimit të lartë mbështetet në një pamje të hapur të bashkëpunimit dhe partneritetit me institucionet arsimore dhe

¹ Anex I. Dok. 1.1. Statuti UNIKO, Neni 1-2; Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Misioni, fq.9)

² Anex I. Dok. 1.2. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Misioni, fq.9)

³ Anex I. Dok. 1.3. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve;

⁴ Anex I. Dok. 1.4. Shembull praktike e studimit të tregut të punës programi 2-vjeçar me karakter profesional.

⁵ Anex I. Dok. 1.5. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Fusha strategjike: Edukimi. fq.21)

⁶ Anex I. Dok. 1.6. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>

⁷ Anex I. Dok. 1.7. Rregulloret e programit të studimit sipas degëve;

⁸ Anex I. Dok. 1.8. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020

⁹ Anex II. Dok. 2.1. Ligji për arsimin e lartë në RSH, Nr. 80/2015, Neni 83.

prishëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	joarsimore, në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.¹⁰ Kurrikula e programeve të studimit aktual është vazhdimisht e ristrukturuar me qëllim të rritjes së vlerës së diplomës së dhënë në tregun e punës. Janë parashikuar programe të reja dyvjeçare profesionale (profesionale) për të hapur me qëllim furnizimin e tregut me kualifikime praktike profesionale.^{11,12,13}
Standardi II.2 - Programet e studimit synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare; Kriteri 2 Programet e studimit synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	Programet i plotësojnë kriteret e këtij standardi.¹⁴
<u>Konkluzione të GVB:</u> Konstatohet se programet e studimit që ofron FSHNH-ja janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIKO 2019-2020 dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këto fusha.	

2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit (përgjegjës për programin/et e studimit)

Pjesa përshkimore

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane u hap në bazë të Urdhrit nr. 16, datë 17.1.2012 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës dhe në nenin 41 të Ligjit “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ky fakultet erdhi si nevojë e një riorganizimi të Fakultetit të Mësuesisë (Fakulteti i Pedagogjisë, me programin e studimit 3-vjeçar “Mësues për Arsimin Fillor”), i themeluar në vitin 1992, me Vendimin nr. 5, datë 7 janar 1992 të Këshillit të Ministrave. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane funksionon në përputhje me kërkesat e “Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij.

Struktura organizative e fakultetit është në përputhje me statutin, ky element konstatohet edhe nga GVJ në raportin përfundimtar.

¹⁰ Anex II. Dok. 2.2. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> (Bashkëpunime)

¹¹ Anex II. Dok. 2.3.VKM Nr. 514, dt. datë 20.9.2017 “PËR MIRATIMIN E LISTËS KOMBËTARE TË PROFESIONEVE (LKP), TË RISHIKUAR”

https://www.google.com/search?q=Lista+kombetare+e+profesioneve&rlz=1C1CHBF_enAL819AL819&oq=Lista+kombetare+e+profesioneve&aqs=chrome..69i57j69i60l2.6387j0j7&sourceid=chrome&ie=UTF-8

¹² Anex II. Dok. 2.4. Rregullore e programit profesional “Shërbim Social”

¹³ Anex II. Dok. 2.5. Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO 2016-2020, (Harta strategjike, A.1. – A.3; fq. 19)

¹⁴ Anex II. Dok. 2.6. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve-Objektivat formuese


Tregues të matshëm:

☑ Struktura didaktike (Departamentet) për programet e studimit

ORGANIGRAMA e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane është miratuar me Vendim të Senatit Akademik, Nr. 138, datë 12.03. 2019 dhe me vendim të Bordit të Administrimit, Nr. 182 të datës 03.04.2019.

Dekani është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi i njësisë kryesore.

Zv.dekani është anëtar i Dekanatit dhe i emëruar nga Dekani pas miratimit të kandidaturave të propozuara prej tij. Dekanati koordinon veprimtaritë e njësive bazë të fakultetit.



- **DEPARTAMENTI I SHKENCAVE SOCIALE**

Departamenti i Shkencave Sociale ka në përbërje të tij 14 pedagogë efektivë nga të cilët: 1 Prof.dr.; 1 Prof. as. dr.; 8 Doktor shkencash; 1 PhD; 1 Docent , 1 Msc. 1 në proces doktorature.

- **DEPARTAMENTI I MATEMATIKË-FIZIKËS,**

Departamenti i Matematikë, Fizikës ka aktualisht 12 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët: 1 Prof.dr, 6 Dr, dhe 5 MSc (1 MSc.proces doktorature).

- **DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS**

Departamenti i Informatikës ka aktualisht 8 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët: 3 Dr, dhe 5 MSc (3 MSc.proces doktorature).

- **DEPARTAMENTI I BIOLOGJI-KIMISË**

Departamenti i Biologji-Kimisë ka në përbërje të tij 7 pedagogë efektivë, nga të cilët: 4 Doktorë Shkencash, 1 PhD, 2 Msc. (në proces doktorature).

• **DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Departamenti i Infermierisë ka në përbërje të tij 10 anëtarë; Stafi akademik përbëhet nga: 3 Doktorë shkencash, (prej të cilëve një është edhe docent) dhe 7 Msc.

Përveç stafit akademik, në fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane zhvillon veprimtarinë mbështetëse edhe stafi administrativ, i përbërë nga 10 punonjës, konkretisht: ndihmësja e dekanit, sekretaria mësimore (2 punonjës), Sekretare laborante (6 punonjës), punonjës biblioteke (1 punonjës).

- ☒ **Numri i Personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personeli Administrativ (PA), titujt/gradat**

Tabela 1. Shpërndarja e stafit akademik sipas departamenteve

Nr	Departamenti i:	Nr.i stafit	Prof.dr.	Prof.as.dr.	PhD	Dr.	Doc.	Msc.
1	Shkencave Sociale	14	1	1	1	8	1	2
2	Matematikë-Fizikë	12	1	-	-	6	-	5
3	Informatës	8	-	-	-	3	-	5
4	Biologji-Kimisë	7	-	-	1	4	-	2
5	Infermierisë	11	-	-	-	3	-	8
Σ	Gjithsej	51	2	1	2	24	1	22

Tabela 2. Shpërndarja e stafit administrativ

Nr	Njësia administrative	Nr.punonjës
1	Ndihmësja e Dekanit	1
2	Sekretaria mësimore	2
3	Sekretare laborante	6
4	Biblioteka	1

Tabela 3. Lista e Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) të Departamenteve

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Departamenti i Shkencave Sociale							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli Grada	Institucioni ku punon full time
1	Gjergji Pendavinji	Dekan	Prof. dr.	1	Gjergj Sinani	Prof.dr.	U.i Tiranës
2	Magdalini Vampa	Përgjegjës	Dr.	2	Edmond Rapti	Prof.dr.	U.i Tiranës
3	Josif Minga	Pedagog	Prof.as. dr.	3	Zyhdi Dervishi	Prof.dr.	U. i Tiranës
4	Denisa Titili	Pedagog	Dr.	4	Theodhori Karaj	Prof.dr.	U. i Tiranës
5	Maria Dojçe	Pedagog	Dr.	5	Dhorina Theodhori	Msc.	Prokuroria, Korçë
6	Jordan Jorgji	Pedagog	Dr.	6	Eglantina Belishta	Msc.	Korçë
7	Eriseld Kalemaj	Pedagog	Dr.	7	Ciljeta Simaku	Msc.	Q. Shëndetit Mendor,

							Korçë
8	Alket Dino	Pedagog	Dr.	8	Laert Civici	Msc.	Prokurori
9	Ina Zallëmi	Pedagog	Dr.	9	Atina Irakli	Dr.	Drejtoria e Doganave
10	Mitjana Profiri	Pedagog	Dr.	10	Lirime Cukaj	Prof.as.dr.	U. i Tiranës
11	Suela Iblilaimllari	Pedagog	Dr.		Andi Petro	Msc.	Psikolog shkolle
12	Ardian Matka	Pedagog	Doc.				
13	Viola Dolani	Pedagog	Msc.				
14	Elona Kodhel	Pedagog	Doktorant				

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Departamenti i Matematikw-Fizë

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli Grada	Institucioni ku punon full time
1	Arto Adili	Përgjegjës	Dr.	1	Kujtim Dule	Prof.as.dr	UT
2	Lorenc Ekonomi	Zv. Dekan	Prof.dr.	2	Halil Sykja	Prof.dr	UT
3	Lorena Margo	Zv. Dekan	Dr.	3	Margarita Ifti	Prof.dr	UT
4	Esmeralda Guliqani	Pedagog	Msc.	4	Maria Dede	Prof.dr	UT
5	Eljona Milo	Pedagog	Dr.	5	Mimoza Hafizi	Prof.dr.	UT
6	Danjela Braho	Pedagog	Dr.	6	Polikron Dhoqina	Prof.as.dr	UT
7	Anxhelina Qorllari	Pedagog	Msc.	7	Kristaq Mosko	Msc.	Shkolla e mesme “Ymer Dishnica”
8	Edlira Donevski	Pedagog	Msc.	8	Klajdi Pllaha	Msc.	Kolegji “Preka”
9	Silvja çobani	Pedagog	Msc.	9	Ardit Agolli	Msc.	Shkolla 9-vecare
10	Ilir Palla	Pedagog	Dr.	10	Julita Bimbli	Msc.	
11	Lorena Kelo	Pedagog	Dr.	11	Fjoralba Lico	Msc.	
12	Sotirag Marko	Pedagog	Msc.	12	Radiola Guliqani	Msc.	
				13	Remina Isuflari	Msc.	
				14	Dhimitra Qirjo	Msc.	
				15	Xhulia Benga	Msc.	
				16	Emilena Ismail	Msc.	

Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Humane. Departamenti i Informatikës

1	Rafail Prodani	Përgjegjës	Dr.		Igli Tafa	Prof.as.dr	UT
2	Blerina Celiku	Pedagog	Dr.	2	Ervin Ramollari	Msc.	Korçë
3	Dhori Beta	Pedagog	Msc.	3	Gjergji Mulla	Dr.	UT
4	Marjon Pano	Pedagog	Dr.	4	Anxhela Shaholli	Msc.	Korçë
5	Erma Pema	Pedagog	Msc.	5	Xhensila Morava	Msc.	Korçë
6	Emis Simo	Pedagog	Msc.	6	Kristi Lëmi	Msc.	Korçë
7	Marsel Kotori	Pedagog	Msc.	7	Nasian Matka	Msc.	Kolegji Preka
				8	Ina Agolli Shkembi	Msc.	Korçë
				9	Megi Koleci	Msc.	Bashkia Korçë
				10	Marinela Coclli	Msc.	Shkolla e Mesme Profesionale TIK
				11	Sotirag Doj#e	Msc.	Shkolla e mesme “Demir Progri”
				12	Kleanthi Nikolla	Msc.	Korçë
				13	Gentian Shkembi	Msc.	Korçë

				14	Mikele Kodra	Msc.	Korcë
				15	Alketa Dragoi	Msc.	Korcë

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane . Departamenti i Biologji-Kimisë

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli Grada	Institucioni ku punon full time
1	Arben Gjata	Përgjegjës	Dr.	1	Emanuela Zerelli	Msc	Korce
2	Redi Buzo	Pedagog	Dr.	2	Emanuela Bregu	Msc	Shkolla e Mesme “Medreseja”
3	Gloria Dimco	Pedagog	PhD.	3			
4	Desareda Mero	Pedagog	Dr.				
5	Tanja Kamburi	Pedagog	Dr.				
6	Xhuljana Qirinxhi	Pedagog	Msc.				
7	Eralda Belishta	Pedagog	Msc.				

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Departamenti i Infermierisë

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli Grada	Institucioni ku punon full time
1	Eda Stasa	Përgjegjës	Dr.	1	Enver Roshi	Prof. Dr.	U. i Tiranës
2	Elda Panariti	Pedagog	Dr.	2	Edmond Laho	Prof.as.dr	Spitali Elbasan
3	Lindita Terolli	Pedagog	Doc.	3	Spiro Pine	Msc.	Spitali Korçë
4	Elena Drenesku	Pedagog	Msc.	4	Ilija Skëndi	Dr.	Spitali Korçë
5	Emisa Velo	Pedagog	Msc.	5	Gjergji Gjata	Dr.	Spitali Korçë
6	Blendi Baze	Pedagog	Msc.	6	Ema Lumi	Dr.	Spitali Korçë
7	Zhinzela Qyli	Pedagog	Msc.	7	Koco Mati	Msc.	Spitali Korcw
8	Adelina Galica	Pedagog	Msc.	8	Reitano Galica	Msc.	Spitali Korçë
				9	Mishel Papagozma	Msc.	Spitali Korçë
9	Erisa Grabocka	Pedagog	Msc.	10	Merita Kroj	Msc.	DRShëndetit
10	Paola Saro	Pedagog	Msc.	11	Ornela Ruço	Msc.	Spitali Korçë
				12	Ylli Ciko	Msc.	Spitali Korçë
				13	Gerla Koleci	Msc.	Spitali Korçë
				14	Rolandi Lalaj	Msc.	Q. SH. Mendor
				15	Brixhilda Lilka	Msc.	Spitali Korçë
				16	Luan Belortaja	Msc.	Spitali Korçë
				17	Gjergji Mikerezi	Msc.	Spitali Korçë
				18	Blerta Qazimllari	Msc.	Spitali Korçë
				19	Arjola Naci	Msc.	Spitali Korçë
				20	Ilirjan Koroveshi	Msc.	Spitali Korçë
				21	Maqo Andoni	Msc.	Spitali Korçë
				22	Krisela Mulliri	Msc.	Spitali Korçë
				23	Alvin Naum	Msc.	DRShëndetit
				24	Thanas Sino	Msc.	Spitali Korçë
				25	Elda Zavalani	Msc.	Farmaci
				26	Irena Laska	Msc.	Q. K. Paliativ
				27	Klajdi Belishta	Msc.	Q. Shëndetësore
				28	Albana Koçibelli	Msc.	Spitali Korçë
				29	Ardian Caprazi	Msc.	Spitali Korçë
				30	Nada Terpo	Msc.	DSHP Korcw
				31	Majlinda Gjançi	MP.	Spitali Korçë
				32	Jani Nune	MP.	Spitali Korçë
				33	Margarita Jazxhi	MP.	Poliklinikë
				34	Denisa Mançi	Msc.	Spitali Korçë
				35	Lorena Thano	MP.	Spitali Korçë

				36	Nertila Ameda	MP.	Laborator
				37	Nikolina Bode	Msc.	Q. Sh. Mendor

☒ **Këshilli Shkencor i Programeve të studimit/Koordinatori/ët e programeve të studimit**


Tabela 4. Këshilli Shkencor i Programeve të studimit/Koordinatori/ët e programeve të studimit

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Gjergji Pendavinji	Prof.dr.	Kryetar
Magdalini Vampa	Dr.	Anëtar
Arto Adili	Dr.	Anëtar
Lorenc Ekonomi	Prof.dr.	Anëtar
Eda Stasa	Dr.	Anëtar
Jordan Jorgji	PhD.	Koordinator - Departamenti i Shkencave Sociale
Blerina Çeliku	Dr.	Koordinator – Departamenti i Informatikës
Desareda Mero	Dr.	Koordinator – Departamenti i Biologji-Kimisë
Blendi Baze	Msc.	Koordinator – Departamenti i Infermierisë

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programet e studimit

Pjesa përshkimore

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane ka aktualisht 62 punonjës: 52 punonjës staf akademik dhe 9 punonjës ndihmësmësimorë (Ndihmëse e dekanit, sekretare mësimore, sekretare departamentesh), 1 punonjës biblioteke. Në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane bëjnë pjesë 52 pedagogë të brendshëm prej të cilëve 2 mbajnë titullin Profesor, 1 Profesor i asociuar, 2 PhD, 21 Doktorë shkencash, 1 Docent, si dhe 24 me gradën Master i Shkencave (në proces doktorature).



Raporti midis stafit mësimdhënës dhe numrit të studentëve për çdo kurs studimi në vitin akademik 2019-2020 varion nga: **1/4** për programin : “Filozofi-Sociologji”;

“Biologji-Kimi; “Matematikë-Fizikë, Informatikë” në **1/12** për programet “Administrim dhe Politika Sociale” dhe “Infermieri e Përgjithshme”; “Mami/Infermieri”. Në programet e ciklit të dytë “Master” raporti staf/student varion midis **1/6** deri **1/10**. **86 %** të orëve mbulohen me pedagogë të brendshëm dhe **14%** me pedagogë të ftuar. Raporti staf i kualifikuar, staf i pakualifikuar. **86 %** staf i kualifikuar dhe **14%** staf i pakualifikuar .

Raporti staf i brendshëm, staf i jashtëm. **70 % / 30%**

Punonjësit e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit pranohen me konkurim publik. Kriteret specifike të konkurrimit për të dyja kategoritë propozohen nga departamenti përkatës dhe miratohen nga Dekani. Këto kriteret i përcillen Rektorit për miratim nga Sektori i Burimeve Njerëzore. - Për zhvillimin e konkursit Dekani i Fakultetit ngre një komision të përbërë nga përfaqësues të Departamentit, të Fakultetit dhe të Universitetit. Në komision, marrin pjesë Zv/Rektori, Përgjegjësi i Degës së Burimeve Njerëzore dhe Përgjegjësi i Departamentit. Komisioni harton dhe i paraqet Rektorit për miratim pikët e vlerësimit për çdo kriter të veçantë. Rektorati bën shpalljet përkatëse. Konkursi zhvillohet në afatet e përcaktuara sipas rregullave në fuqi. - Kandidatët e përzgjedhur, me përjashtim të kategorisë “Profesorë” (Profesorëve dhe Profesorëve të Asociuar), merren me kontratë njëvjeçare, mbështetur në ligjin “Për Arsimin e Lartë në RSH”, i ndryshuar dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimin e personelit akademik, sipas përcaktimeve të pikës 1 të nenit 47 të ligjit të mësipërm. Kontrata nënshkruhet nga i punësuari dhe Rektori. Pas përfundimit të kontratës dhe plotësimit të kushteve të saj, për punonjësit me gradë shkencore, kontrata mund të kthehet në definitive. Punonjësit pa gradë shkencore mund të merren vetëm me kontratë të përsëritshme deri në 3 vjet. - Pedagogët e ftuar, pasi rezultojnë fitues në konkurs, merren me kontratë njëvjeçare. - Punonjësit akademikë të ftuar propozohen nga departamenti në bazë të nevojave të tyre dhe miratohen nga dekan i fakultetit dhe Rektori i Universitetit.

- Punonjësit mësimorë të huaj pranohen në procesin mësimor me propozim të dekanit dhe vendim të Senatit të Universitetit. Në përfundim të procedurave të rekrutimit të stafit të ri akademik, materialet informative (njoftimet për punë), dosjet e plota të kandidatëve që kanë aplikuar dhe atyre që janë shpallur fitues, vendimet e marra nga komisionet e fakulteteve dhe vendimet e Senatit depozitohen të gjitha pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Universitet. Pedagogët e brendshëm dhe të ftuar përzgjidhen në bazë të dosjes individuale të aplikimit (dokumentacionit të kualifikimeve profesionale). Për përzgjedhjen e kandidatëve vendos Rektori i Shkollës (që ka edhe cilësinë e punëdhënësit), i cili mund të tërheqë sipas rastit mendimin e Dekanit të Fakultetit apo Përgjegjësit të Departamentit, ku kandidati aplikon. Kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për pedagogë përcaktohen nga departamenti për të cilin aplikon kandidati, në përputhje me legjislacionin në fuqi për Arsimin e Lartë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. Pedagogët e huaj pranohen në bazë të marrëveshjeve dypalëshe Dosjet e personelit akademik të brendshëm dhe administrativ kanë në përbërje dokumentacionin e mëposhtëm: Dokumentin e identitetit (fotokopje e pasaportës ose kartës së identitetit) Dokumentin që vërteton punën e kryer më parë (librezë pune ose vërtetim nga punëdhënësi i mëparshëm) Librezën e sigurimit shoqëror e shëndetësor Diplomën e shkollës së lartë dhe listën e notave Kualifikimet e tjera profesionale (brenda ose jashtë vendit) Gradat shkencore apo titujt akademikë Raportin mjekësor për aftësimin në punë ose librezën shëndetësore, lëshuar nga inspektoriat i sanitar shtetëror endbanimit ose ndonjë dokument tjetër të nevojshëm, sipas specifikës së

vendit të punës. E gjithë procedura pasqyrohet në statutin e UNIKO. (Të gjitha këto të dhëna gjenden tek Zyra e Byrimeve Njerëzore të Universitetit).

Tregues të matshëm:

Tabela 5. Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe ndihmës akademik për programet e studimit

Stafi akademik i programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020 (Dep. i Shkencave Sociale)						
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Institucioni ku punon full time
1	Magdalini Vampa	Përgjegjës	Dr.	1	Gjergj Sinani	Prof.dr U. i Tiranës
2	Gjergji Pendavinji	Dekan	Prof.dr.	2	Zyhdi Dervishi	Prof.dr U. i Tiranës
3	Josif Minga	Pedagog	Prof.as.d r.	3	Edmond Rapti	Prof.dr U. i Tiranës
4	Ardian Matka	Pedagog	Doc.	4	Theodhori Karaj	Prof.dr U. i Tiranës
5	Alket Dino	Pedagog	Dr.	5	Dhorina Theodhori	Msc. Prokuroria Korçë
6	Eriseld Kalemaj	Pedagog	Dr.	6	Eglantina Belishta	Msc. Korçë
7	Denisa Titili	Pedagog	Dr.	7	Ciljeta Simaku	Msc. Q. e Shëndetit Mendor, Korçë
8	Jordan Jorgji	Pedagog	PhD.	8	Laert Civici	Msc. Prokuroria Korce
9	Elona Kodhel	Pedagog	Doktoran te	9	Atina Irakli	Msc Drejtoria e Doganave
10	Viola Dolani	Pedagog	Msc.	10	Lirime Cukaj	Prof.as. dr. U. i Tiranës
11	Maria Dojçe	Pedagog	Dr.	11	Andi Petro	Msc Psikolog Shkolle
12	Mitjana Profiri	Pedagog	Dr.			
13	Suela Ibrahimllari	Pedagog	Dr.			
14	Ina Zallëmi	Pedagog	Dr.			

Stafi akademik i programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020 (Dep. i Matematikë-Fizikës)						
PAE (Emër, Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	PAK (Emër, Mbiemër)		Institucioni ku punon full time
1	Arto Adili	Përgjegjës	Dr.	1	Kujtim Dule	Prof. as.dr. UT
2	Lorenc Konomi	Zv. Dekan	Prof.dr.	2	Halil Sykja	Prof. dr. UT
3	Lorena Margo	Zv. Dekan	Dr.	3	Margarita Ifti	Prof. dr. UT
4	Eliona Milo	Pedagog	Dr.	4	Maria Dede	Prof. dr. UT
5	Danjela Braho	Pedagog	Dr.	5	Mimoza Hafizi	Prof. dr. UT
6	Ilir Palla	Pedagog	Dr.	6	Polikron Dhoqina	Prof.as. dr. UT
7	Edlira Donevski	Pedagog	Msc.	7	Kristaq Mosko	Msc. Shkolla e mesme “Ymer Dishnica”
8	Silvja Cobani	Pedagog	Msc.	8	Klajdi Pllaha	Msc. Kolegji “Preka” Korçë
9	Lorena Kelo	Pedagog	Dr.	9	Ardit Agolli	Msc. Korçë
10	Sotirag Marko	Pedagog	Msc.	10	Julita Bimbli	Msc. Korçë
11	Esmeralda Guliqani	Pedagog	Msc.	11	Fjoralba Lico	Msc. Korçë

12	Anxhela Qorllari	Pedagog	Msc.	12	Gladiola Guliqani	Msc.	Korcë
				13	Romina Isuflari	Msc.	Korcë
				14	Dhimitra Qirjo	Msc.	Korcë
				15	Xhulja Benga	Msc.	Korcë
				16	Emilena Ismail	Msc.	Korcë

Stafi akademik i programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020 (Dep. i Informatikws)						
PAE (Emër, Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/Grada	PAK (Emër, Mbiemër)		Institucioni ku punon full time
1	Rafail Prodani	Përgjegjës	Dr.	1	Igli Tafa	Prof.as.dr. UT
2	Blerina Celiku	Pedagog	Dr.	2	Ervin Ramollari	Dr. UT
3	Marjon Pano	Pedagog	Dr.	3	Gjergji Mulla	Dr. UT
4	Erma Pema	Pedagog	Msc.	4	Anxhela Shaholli	Msc. Korcë
5	Marsel Kotori	Pedagog	Msc.	5	Xhensila Morava	Msc. Korcë
6	Dhori Beta	Pedagog	Msc.	6	Kristi Lwmi	Msc. Korcë
7	Emis Simo	Pedagog	Msc.	7	Nasjan Matka	Msc. Kolegji “Preka”
8	Lorela Sula	Pedagog	Msc.	8	Ina Shkwmbi	Msc. Korcë
				9	Megi Koleci	Msc. Bashkia Korcë
				10	Marinela Coclli	Msc. Shkolla e mesme profesionale TIK
				11	Sotirag Dojce	Msc. Shkolla e mesme “Demir Progri”
				12	Kleanthi Nikolla	Msc. Korcë
				13	Gentian Shkambi	Msc. Korcë
				14	Mikele Kodra	Msc. Korcë
				15	Alketa Dragoi	Msc. Korcë

Stafi akademik i programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020 (D. i Biologji-Kimisë)						
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Institucioni ku punon full time
1	Arben Gjata	Përgjegjës	Dr.	1	Emanuela Zerelli	Msc. -
2	Gloria Dimço	Pedagog	PhD.	2	Emanuela Bregu	Msc. Shkolla e Mesme “Medreseja”
3	Redi Buzo	Pedagog	Dr.	3		
4	Desareda Mero	Pedagog	Dr.			
5	Tanja Kamburi	Pedagog	Dr.			
6	Xhuliana Qirinxhi	Pedagog	Msc.			
7	Eralda Belishta	Pedagog	Msc.			

Stafi akademik i programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020 (D. i Infermierisë)							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli Grada	Institucioni ku punon full time
1	Eda Stasa	Përgjegjës	Dr.	1	Enver Roshi	Prof.dr.	U. i Tiranës
2	Elda Panariti	Pedagog	Dr.	2	Edmond Laho	Prof.as.dr	Spitali Elbasan
3	Lindita Terolli	Pedagog	Doc.	3	Spiro Pine	Msc.	Spitali i Korçës
4	Elena Drenesku	Pedagog	Msc.	4	Ilia Skëndi	Dr.	Spitali i Korçës
5	Emisa Velo	Pedagog	Msc.	5	Gjergji Gjata	Dr.	Spitali i Korçës
6	Blendi Baze	Pedagog	Msc.	6	Ema Lumi	Dr.	Spitali i Korçës
7	Zhinzela Qyli	Pedagog	Msc.	7	Koco Mati	Msc.	Spitali i Korçës
8	Adelina Galica	Pedagog	Msc.	8	Reitano Galica	Msc.	Spitali i Korçës
9	Lida Jorgji	Pedagog		9	Mishel Papakozma	Msc.	Spitali i Korçës
10	Erisa Grabocka	Pedagog	Msc.	10	Merita Kroj	Msc.	DRSHendetit
				11	Ornela Ruço	Msc.	Spitali i Korçës
				12	Ylli Ciko	Msc.	Spitali i Korçës
				13	Gerla Koleci	Msc.	Spitali i Korçës
				14	Rolandi Lalaj	Msc.	Q.Sh. Mendor
				15	Brixhilda Lilka	Msc.	Spitali Korçë
				16	Luan Belertaja	Msc.	Spitali Korçë
				17	Gjergji Mikerezi	Msc.	Spitali Korçë
				18	Blerta Qazimllari	Msc.	Spitali Korçë
				19	Benarda Dervishi	Msc.	Q. SH. Raj. 2
				20	Illirjan Koroveshi	Msc.	Spitali Korçë
				21	Maqo Andoni	Msc.	Spitali Korçë
				22	Krisela Mulliri	Msc.	Spitali Korçë
				23	Alvi Naum	Msc.	DR Shendetësor
				24	Thanas Silo	Msc.	Spitali Korçë
				25	Elda Zavalani	Msc.	Farmaci
				26	Irena Laska	Msc.	Q. K. Paliativ
				27	Klajdi Belishta	Msc.	Q SHëndetësor
				28	Albana Koçibelli	Msc.	Spitali Korçë
				29	Ardian Çaprazi	Msc.	Spitali Korçë
				30	Nada Terpo	Msc.	DSHP
				31	Majlinda Gjançi	MP.	Spitali Korçë
				32	Jani Nune	MP.	Spitali Korçë
				33	Margarita Jazxhi	MP.	Poliklinikë
				34	Denisa Mançi	Msc.	Spitali Korçë
				35	Lorena Thano	MP.	Spitali Korçë
				36	Nertila Ameda	MP.	Laborator
				37	Nikolina Bode	Msc.	Q. Sh. Mendor

Tabela 6. Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Titulli	Stafi akademik i programeve të studimit
---------	---

	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	2	5	2:5
Profesorë të As.	1	2	1:2
Dr/PhD	21	5	21:5
Pedagogë ne proces Dr	4	-	4:0
Asistentë me Msc	20	46	20:46
Docent	2	-	2:0
Totali	51	58	51:58

Tabela 6/1. Të dhëna sipas moshës PAE dhe PA

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë			1	1	
Profesorë të As.				-	1
Dr/PhD	9	6	6		-
Pedagogë ne proces Dr	4	4	1		-
Asistentë me Msc	8	4			-
Docent			2		-
Personeli ndihmës akademik	2	1	1		-
Totali	23	15	11	1	1

Tabela 6/2 Të dhëna sipas moshës PAK

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë				5	
Profesorë të As.			2		
Dr/PhD	1	2	1	2	
Pedagogë ne proces Dr					
Docent				1	
Asistentë me Msc	22	12	1	2	
Personeli ndihmës akademik	-	-	-	-	-
Totali	23	14	4	10	

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbyshja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të	UNIKO i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. ¹⁵ Kriteret shpallen publikisht dhe

¹⁵ Anex III. Dok. 3.1..Statuti UNIKO, Neni 40 <https://www.unkorce.edu.al/statuti-i-universitetit>

angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë; Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.	përzgjedhja bëhet me konkurs.¹⁶ Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv gjenden gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.¹⁷ Sa i takon vlerësimit të performancës, pedagogët i nënshtrohen vlerësimeve nga drejtuesit e njësisë, por edhe gjatë vitit akademik duke përfshirë edhe vlerësimin nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. Departamentet zhvillojnë periodikisht vlerësime të stafit akademik dhe mbajnë një bazë të dhënash për raportet e rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë etj.^{18, 19};
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programeve të studimit; Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ; Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik; Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr.	Departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon.²⁰ Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik²¹; të cilat i ka të parashikuara në dokumente që rregullojnë veprimtarinë e tij.²² Të gjithë departamentet kanë angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve për Programet e studimit të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku titullin Prof. /Prof.as.dr.²³
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë; Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).	Në strukturën organizative janë përfshirë staf ndihmës mësimor dhe IT lidhur me angazhimin maksimal në funksion të ecurisë së punës dhe përmbushjes së objektivave. Kjo është parashikuar si në organogramën e fakultetit, ashtu edhe në rregulloren e studimeve. Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të

¹⁶ Anex III. Dok. 3.2., <http://www.app.gov.al> Buletini Nr. 40 datë 09 Tetor 2017; <http://www.app.gov.al> / Buletini Nr. 39 datë 01 Tetor 2018

¹⁷ Anex III. Dok. 3.3. Praktikë e dosjes së stafit nga burimet njerëzore **shembull**

¹⁸ Anex III. Dok. 3.4. Praktika e vlerësimit të stafit nga drejtuesit e njësisë. **shembull**

¹⁹ Anex III. Dok. 3.5. Procedura e rekrutimit që lidhet me departamentin

²⁰ Anex III. Dok. 3.6. Praktikë e dosjes së stafit nga burimet njerëzore **shembull**

²¹ Anex III. Dok. 3.7. <http://www.app.gov.al> Buletini Nr. 40 datë 09 Tetor 2017; <http://www.app.gov.al> / Buletini Nr. 39 datë 01 Tetor 2018

²² Anex III. Dok.3.8.

https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/STATUTI%20I%20UNIVERSITETIT%20FAN%20S.%20NOLI%20KORCE_0.pdf (Neni 40)

²³ Anex III. Dok. 3.9.

	mësimi. Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarë-vajtjen e procesit akademik.^{24, 25} Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale FSHNH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet publike(DAR/ZA) (Bashkia Korçë) për të garantuar zhvillimin e praktikave në institucionet vartëse të tyre (shkolla të mesme) (zyrat e administratës publike).²⁶ Përveç praktikave në institucione, studentët zhvillojnë dhe ekspedita mësimore. Në të dy rastet departamentet angazhojnë pedagogë që ndjekin studentët në praktika mësimore apo ekspedita. Këtë angazhim pedagogët e parashikojnë në formularin që bëjnë për ngarkesën vjetore të punës së tyre.²⁷ Dërgimi i studentëve në praktika mësimore apo ekspedita mësimore bëhet sipas një procedure standarde midis Departamentit-Dekanit dhe në rastin e ekspeditave edhe me zyrën e prokurimeve në institucion.^{28, 29}
Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor; Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.	Angazhimi në veprimtaritë kërkimore-shkencore dhe kualifikimi i vazhdueshëm janë pjesë e rëndësishme e punës së pedagogut. Rritja e cilësisë së mësimdhënies ka për bazë edhe arritjet në punët kërkimore-shkencore të realizuara nga pedagogët e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. FSHNH është i angazhuar maksimalisht për të nxitur kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij. Ai mbështet zhvillimin e konferencave shkencore nga njësitë bazë; pjesëmarrjen e pedagogëve në konferenca dhe aktivitete të rëndësishme shkencore

²⁴Anex III. Dok. 3.10. Rregullore UNIKO. Neni 3 Struktura organizative; Neni 4, Pika B
<https://www.unkorce.edu.al/sq/rregullore-e-organizimit-dhe-veprimtaris%C3%AB-m%C3%ABsimorek%C3%ABrkimore-shkencore-e-universitetit%E2%80%9Cfan-s-noli%E2%80%9D>.

²⁵ Anex III. Dok. 3.11. (Rregullorja ESSE3)

http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/Rregullore%20per%20ESSE3_%20update%2019_4_2017.pdf

²⁶ Anex III. Dok. 3.12. Model marrëveshjeje bashkëpunimi midis FSHNH dhe Bashkisë Korçë për zhvillimin e praktikave profesionale

²⁷ Anex III. Dok. 3.13. Model i organizimit të ngarkesës vjetore të punës së pedagogut ku përfshihet praktika mësimore apo ekspedita në terren;

²⁸Anex III. Dok. 3.14. Model i shkresës përcjellëse pranë DAR/ZA-ve dhe listës së studentëve që dërgohen për praktikë në shkollat e mesme

²⁹ Anex III. Dok. 3.15. Model i procedurës për zhvillimin e ekspeditave mësimore të studentëve të programit Bachelor (Biologji-Kimi)

	Brenda dhe jashtë vendit të cilat pasqyrohen në faqen zyrtare të UNIKO dhe FSHNH.^{30, 31, 32}. Gjithashtu pedagogët në (FSHNH)UNIKO, gëzojnë të drejtën të përfitojnë vitin sabatik të paguar, e parashikuar në rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore e universitetit “Fan S. Noli”³³ dhe në Statutin e UNIKO.³⁴ Duke njohur sfidat me të cilat ballafaqohet sot shoqëria jonë, UNIKO është përkushtuar për të siguruar arritje të qëndrueshme nëpërmjet programeve të kërkimit dhe zhvillimit, të cilat janë të hapura për të gjithë stafin.^{35, 36} Në faqen zyrtare të UNIKO disponohet një bazë të dhënash për të gjithë të programet e studimeve të ofruara nga FEF-i sipas cikleve ³⁷.
--	---

Konkluzione të GVB:

Në FSHNH vëmë re një përpjekje serioze për të ngritur një sistem të përzgjedhjes së personelit akademik bazuar mbi kriteret transparente dhe të meritokracisë. Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe vlerësimit të performancës së personelit akademik, si në aspektin e mësimdhënies, ashtu edhe sa i përket veprimtarisë kërkimore shkencore dhe kualifikimit të mëtijshëm. Këta elementë janë pjesë e kontratës së pedagogut.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane disponon mjedise bashkëkohore për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike në të gjithë fakultetin. Ky fakultet ka një sipërfaqe prej 4450 m², si dhe një infrastrukturë moderne me kushte të përshtatshme për mësim dhe veprimtari shkencore: amfiteatër, 7 salla leksionesh, 7 salla seminare, laboratorë të infermierisë, kimisë, shkencave kompjuterike, fizikës etj, 1 Qendër Ekselence së bashku me një bibliotekë të pasur etj. Infrastruktura e universitetit është moderne: ajo përmban klasa me hapësira të mëdha për kurset me numur të konsiderueshëm studentësh, si dhe klasa të vogla për kurse me një numër më të vogël të studentëve; të gjitha klasat janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike. Fakulteti disponon një Amfiteatër me të gjithë hapësirën dhe

³⁰ Anex III. Dok.3.16.. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor>; (Veprimtaritë)

³¹ AnexIII.Dok.3.17. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/Filozofia%20si%20menyre%20jetese%202017.pdf> (Veprimtari)

³² Anex III. Dok. 3.18.

<https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/konferenca%20didaktike%2010%2011%20nendor%2017.pdf> (Veprimtari shkencore FSHNH)

³³ Anex III. Dok.3.19. Rregullore UNIKO (Neni 37).

https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/RREGULLORE%20E%20ORGANIZIMIT%20DHE%20VEPRIMTARISE%20MESIMORE_0.pdf

³⁴ Anex III. Dok.3.20. Statuti UNIKO (Neni39).

https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/STATUTI%20I%20UNIVERSITETIT%20FAN%20S.%20NOLI%20KORCE_0.pdf

³⁵ Anex III. Dok. 3.21. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> (Projektet)

³⁶ Anex III. Dok. 3.22. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> (Erasmus +)

³⁷ Anex III. Dok. 3.23. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

pajisjet e duhura dhe me kapacitet 140 poste, salla konferencash ku zhvillohen aktivitete shkencore, të cilat janë të pajisura me kompjuter, videoprojektor, ekrane të mëdha, whiteboards etj. Ndërkohë, klasat janë të pajisura me të gjitha facilitetet e nevojshme për të lehtësuar si punën në grupe të mëdha, ashtu dhe atë në grupe të vogla. Videokasetat dhe CD janë pjesë e zhvillimit të orëve të ndryshme mësimore; pedagogët përdorin filma dhe dokumentarë si pikënisje të debateve dhe diskutimeve për një temë të caktuar, por njëkohësisht nxitin edhe studentët t'i përdorin në maksimum mjete të tilla.

Tregues të matshëm:

Tabela 7. Mjediset e fakultetit³⁸

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin/et e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	7	360 m ²
Klasa për seminare	7	185 m ²
Laboratorë për lëndët	11	335 m ²
Laboratorë informatike	2	75 m ²
Salla interneti	2	72 m ²
Salla për bibliotekë	2	80 m ²
Mjedis për promovime	1	30 m ²
Zyrë informacioni për studentët	3	63 m ²
Korridore/holle	7	410 m ²
Mjedise ndihmëse	7	220 m ²
Zyra për stafin	8	200 m ²
Nyje hidrosanitare për studentët	6	110 m ²
Nyje hidrosanitare për stafin	4	85 m ²
Sip Totale e brendshme		4450 m ²
Ambjente m ² /për student/Fakultet	2.27 m ²	
Ambjente m ² /për personel/Fakultet	5.6 m ²	
Oborre/ambjente te jashtme/parkime/ambiente per aktivitete shlodhese	10.800 m ²	E përbashkët për të gjithë universitetin

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE	
BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	

³⁸ Anex IV. Dok. 4.1. Dokumentacioni përkatës për planimetritë e mjedisve

Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore; Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programeve të studimit; Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programeve të studimit; Kriteri 4 Përgjegjësit e programeve hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të; Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimit dhe nevojat e studentëve.	Biblioteka ka një fond prej rreth 10592 libra e revista, me rreth 1031 tituj, të cilat shfrytëzohen nga studentë e pedagogë të fakultetit . Rreth 1544 libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohet në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe, rreth 9048 mijë, në gjuhën shqipe. Fondi i librave dhe revistave është i klasifikuar sipas natyrës së departamenteve dhe fushave përkatëse të studimit. Librat që ofron kjo bibliotekë janë të ndryshëm në përputhje me kërkesat. Tematika e tyre është e gjerë, kryesisht janë libra shkencorë dhe artistikë. Ka përgjithësisht libra për matematikën, fizikën, biologjinë, kiminë, psikologjinë, edukimin, studime shkencore të fushave sociale, tema disertacioni, revista, buletine etj. Ajo drejtohet nga një punonjës i kualifikuar e trajnuar për të përmbushur të gjitha proceset e punës në bibliotekë. Biblioteka, e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura , është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim, studim e fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare. Biblioteka frekuentohet prej studentëve të sistemit me dhe pa shkëputje, studentë të masterit dhe pedagogëve, jo vetëm për të huazuar libra , por dhe për të studiuar në sallë.³⁹ Në fakultet funksionon dhe Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond të specializuar librash dhe revistash në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies në shqip e gjuhë të huaja. Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond 190 tituj (shqip) 490 tituj (gjuhë të huaj).⁴⁰ Studentët mund të shfrytëzojnë dhe një pjesë të konsiderueshme të fondit të librave në bibliotekën shkencore të vendosur pranë Rektoratit⁴¹ . Prej datës 1 mars 2019, stafit mësimdhënës, studentëve të Universitetit “Fan S. Noli”, si dhe komunitetit të Korçës, u ofrohet një mundësi e re qasjeje në Bibliotekën Digjitale ProQuest. UNIKO bleu të drejtën e anëtarësimit në këtë Bibliotekë për periudhën 1 mars 2019 deri më 28 shkurt 2020, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit lidhur midis UNIKO dhe ProQuest. Shërbimi do të jetë aktiv për stafin në vendin e punës, për studentët dhe për komunitetin në mjediset e Bibliotekës Universitare. Në Bibliotekën Digjitale ProQuest,
---	---

³⁹ Anex V. Dok. 5.1. <https://www.unkorce.edu.al/sq/infrastruktura-biblioteka-dhe-laboraret-ne-fshnh>

⁴⁰ Anex V. Dok. 5.2. <https://www.unkorce.edu.al/sq/qendra-te-formimit-te-vazhduar-ne-fshnh>

⁴¹ Anex V. Dok. 5.3. <http://37.139.116.75/sq/biblioteka-uniko>

	gjendet një literaturë bashkëkohore, e cila mbulon fushat parësore të kërkimit në Universitet, si dhe konkretisht edhe në fushën e infermieristikës, shkencave sociale, matematikës, biologjisë dhe kimisë, etj.⁴² Orari i shpallur gjatë ditëve të javës është 8:00-16:00. Studentët dhe pedagogët kanë kartelat e tyre personale në bibliotekë. Çdo student apo pjesëtar i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe komuniteti kanë të drejtë të bëhen anëtare të bibliotekës universitare.⁴³
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programeve; Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve; Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator. Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, lingvistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programe stimulimi për shkencat sociale etj. Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.	FSHNH ka aktualisht në përdorim 12 laboratorë mësimorë. 2 laboratorë kompjuterikë me kapacitet 24 vende, të pajisur me projektor dhe sistem të instaluar fonie.(Auditori 322;223) 2 laboratorë fizike me kapacitet 30 vende, të pajisur me projektor dhe të gjitha mjetet e duhura për të zhvilluar eksperimentet e nevojshme gjatë orës së mësimi(Auditori 218, 005) 1 laborator kimie me të gjitha pajisjet e nevojshme për kryerjen e eksperimenteve, përfshi këtu edhe lëndët kimike të nevojshme për kryerjen e orëve të mësimi. (auditori 115) 1 laborator kirurgjikal, 1 laborator Obsetrikë-Gjinekologji, 2 laboratorë Anatomo-Fiziologjisë dhe 3 laboratorë infermieristikë. 1 amfiteatër me 120 vende me pajisje audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, ku përfshihen PC-te projektorët, dhe sistemi i fonisë. 5 salla auditorësh me kapacitet prej 50-70 vendesh, të gjitha të pajisura me projektor 13 salla seminaresh me kapacitet prej 30-50 vendesh, të cilat janë të pajisura me projektor. 1 Qendër Ekselence e pajisur me 1 videoprojektor, 1 smart board, 1 kompjuter, 1 printer, minibibliotekë të specializuar në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies. 1 bibliotekë e cila shërben njëkohësisht si sallë studimi me fonde të hapura , është e pajisur me kompjutera, internet si dhe me sistem ngrohje që u vjen shumë në ndihmë studentëve për lexim, studim e fotokopje të materialeve të ndryshme bibliotekare. Sekretaria Mësimore është njësia pranë së cilës

⁴² Anex V. Dok. 5.4. <https://search.proquest.com/?accountid=143248>

⁴³ Anex V. Dok. 5.5. <http://37.139.116.75/sq/biblioteka-uniko>

	zhvillohet procesi administrativ brenda Fakultetit, e cila është e pajisur me paisjet e duhura për zhvillimin normal të punës administrative, dhe konkretisht 2 sete Kompjuterash, 1 printer dhe 1 printer – fotokopje. Pranë sekretarisë mbahet edhe një pjesë e Arkivit, si edhe regjistrat bazë të shkollës. Zyra e informacionit për studentët, 2 sete kompjuterash, 1 printer-fotokopje Departamentet: Në total janë 6 salla departamentesh të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të tyre si sete kompjuterike, printer HP etj. Zyra e Dekanit: -1- në të cilën Dekani kryen të gjithë veprimtarinë e tij administrative, të pajisura me 1 set Kompjuter, 1 printer, rafte arkivimi, bibliotekë personale, TV.etj. Në paradhomën e zyrës së dekanit punon asistentja e tij, e cila shfrytëzon 1 set Kompjuter, 1 printer, 1 fotokopje, rafte arkivimi. Mjediset e fakultetit janë të mbuluara me sinjal WiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Paisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e biologji-kimisë janë paisur me të gjitha materialet e nevojshme për kryerjen e eksperimenteve, përfshi këtu edhe teleskopë të sofistikuar në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor.⁴⁴
<u>Konkluzione të GVB:</u> Infrastruktura në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë bashkëkohore dhe të mobiluara me të gjitha kriteret e nevojshme për një process mësimor të standarteve bashkëkohore, me sistem ngrohjeje qëndore në dimer dhe një pjesë e mjediseve (zyrave) edhe me sistem ftohjeje si dhe sistem internet me kabëll dhe ëireless. Mjediset e leksioneve dhe seminareve kanë siguruar një hapësirë të madhe për studentët. Në mjediset e leksioneve studion një numër maksimal prej 60 studentësh (120 studentë në amfiteatër), ndërsa për një sallë seminaresh është përcaktuar një numër maksimal prej 40 studentësh. Pra, parë në këndvështrimin praktik, përmes këtij kapaciteti, studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimdhënies. Studentët gëzojnë akses të plotë me internetin, cilësia e të cilit është e lartë. Çdo sallë mësimore është e pajisur me projektor. Laboratorët janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në departamente. Përgjigjësit e departamenteve janë akomoduar në zyra dyshe, Dekani është akomoduar në zyrë individuale.	

⁴⁴ Anex V. Dok. 5.6. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> (Lab. Database.pdf)

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Tregues të matshëm:

- ☒ Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit (plotëso tabelën 8)

Tabela 8

Nr. Llog.	Zërat	Plan 2019	Fakt 2020
600	Paga	240,000,000	239,707,368
601	Sigurime Shoqërore	40,000,000	39,989,008
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,000,000	4,925,377
606	Transferta per Buxh.fam dhe Indiv.	25,227,000	21,833,925
600	Paga	58,318,462	36,737,624
601	Sigurime Shoqërore		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	68,107,370	46,455,475
606	Transferta per Buxh.fam dhe Indiv.	400,000	356,903
A	Total shpenzime kapitale	437,052,832	390,005,680
230	Kapitale të Patrupëzuara	272,000	172,000
231	Kapitale të Trupëzuara	55,592,090	45,628,294
B	Total shpenzime korrente	55,864,090	45,800,294
	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit	182,689,922	129,350,296
C	TOTAL (A) + (B)	492,916,922	435,805,974

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.

Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;
Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;
Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;
Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;
Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Konkluzione të GVB:

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, në funksion të programeve të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: ngritja dhe institucionalizimi i Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë vepron Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit çdo vit vlerësime të cilësisë, të cilat janë diskutuar dhe në mbledhje të veçanta në senat. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është një organizëm që ngrihet dhe funksionon në nivel institucioni i cili ka përgjegjësinë për të garantuar se Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane i plotëson standardet e cilësisë. Ky organizëm përgjigjet për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVB i raporton drejtpërdrejtë NJSBC në institucion.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike kujdesen strukturat organizative drejtuese të UNIKO, të cilat janë ngritur e veprojnë konform kërkesave të Ligjit 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e

Shqipërisë”, si dhe Njësia e Sigurimit të Brendëshëm të Cilësisë (NJSBC).⁴⁵ Aktivitetin e saj NJSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.⁴⁶

Tregues të matshëm:

☒ Të dhëna për anëtarët e NJBSC

Tabela 9

	Anëtarët e NJBSC	Detyra që ka në NJBSC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Maria Doçe	Përgjegjës	5 vjet
2	Blerina Çeliku	Anëtar	3 vit
3	Desareda Mero	Anëtar	5 vjet
4	Blendi Baze	Anëtar	8 vjet
5	Katerina Sotir	Anëtar	1 vjet

- ☒ Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët e programeve të studimit
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

- ☒ Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel programi studimi
- ☒ Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- ☒ Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- ☒ Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme
- ☒ Dokumentacioni përkatës

Një nga format më të përdorura mbi matjen e cilësisë së mësimit në FSHNH është pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, sipas planit kalendar të hartuar nga njësia qendrore në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Pyetësori ka qenë anonim dhe i realizuar në mënyrë elektronike. Në pyetësorin e fundvitit janë përfshirë vetëm 160 studentë. Skedat e pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës, ndërsa rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit. Njëherazi, ato kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit.

Ndër problematikat më të prekshme dhe më kryesore të evidentuara nga pyetësorët përmenden.

- Mënyra se si organizohet praktika në institucione
- Evidentimi i disa lëndëve si të papërshtatshme për programin e tyre të studimit.
- Cilësia e materialeve mësimore (literaturës) së ofruar studentëve
- Cilësia e performancës së pedagogëve
- Komunikimi pedagog-student
- Konceptimi i aspekteve korruptive apo shkeljeve sipas studentëve
- Cilësia në shpjegim dhe kontroll, etj.

⁴⁵ Anex VI. Dok. 6.1. <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/800>

⁴⁶ Anex V. Dok. 6.2. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/2017-2018%20PLANI%20SKSC.pdf>

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional; Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë; Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: Të tërthorta: - Sondazhe: të studentëve që ndjekin Programet e studimit, të të diplomuarve; - Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; - Pyetje konceptuale; - Intervista; - Etj. Të drejtpërdrejta: - Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me nota/pikë; - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; - Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; - etj.	FSHNH përdor metodologji vlerësimi për tërë veprimtaritë me karakter kontrolli që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë NJBSC në shkallë universiteti. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC.⁴⁷ Për çdo vit akademik Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë harton kalendarin e veprimtarisë së sektorit të kurrikulave dhe sigurimit të cilësisë i cili ndiqet nga NJSBC së fakultetit.⁴⁸ NJSBC kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me pyetësorë me të gjithë studentët, për lëndët dhe pedagogët. Rezultatet përpunohen në raporte periodike.⁴⁹
VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimit.	
Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe	UNIKO ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional Vendim të Bordit të Akreditimit nr.65, datë 21.09.2017^{50,51}, të shoqëruar me certifikatën e akreditimit.⁵² Sigurimi i cilësisë realizohet përmes

⁴⁷ Anex VI. Dok. 6.3. <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/800>

⁴⁸ Anex VI. Dok. 6.4. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/2017-2018%20PLANI%20SKSC.pdf>

⁴⁹ Anex VI. Dok. 6.5. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/RVB%202016-2017%20UNIKO.pdf>

⁵⁰ Anex VI. Dok. 6.6. <https://www.unkorce.edu.al/sq/article/akreditimi-institucional>

⁵¹ Anex VI. Dok. 6.7. Vendim nr.65, datë 21.09.2017 për Akreditimin e parë të IAL Universiteti “Fan Noli” Korçë https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/VENDIMI%20NR.%2065%20DATE%2021.09.2017%20PER%20AKREDITIMIN%20E%20PARE%20TE%20UNIKO_0.pdf

⁵² Anex VI. Dok. 6.8. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/CERTIFIKATA%20E%20AKREDITIMIT.pdf>

ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron; Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron; Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin Programet e studimit që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to; Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, si edhe bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet.⁵³ Gjithashtu përfaqësues të Këshillit Studentor të Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, bëhen pjesë e takimeve informuese për “Sondazhin Kombëtar të Studentëve”, organizuar nga ASCAL dhe BA⁵⁴ Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UNIKO-së, brenda Drejtorisë së Kurrikulave Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. SKSC-ja përfshin dy drejtime pune që janë pandashmërisht të lidhur me njëri-tjetrin: “Zhvillimin e Programeve Mësimore” dhe “Vlerësimin Institucional”. Në këtë kuadër, ky sektor vazhdon të menaxhojë një rrjet të Sigurimit të Cilësisë në shkallë fakulteti dhe universiteti, i cili funksionon i mirëkoordinuar si në nivelin bazë të infrastrukturës institucionale, ashtu edhe në menaxhimin e burimeve njerëzore.^{55,56}
<u>Konkluzione të GVB:</u> Për sigurimin e cilësisë në FSHNH, tregohet kujdes i veçantë. Ai, ashtu si në gjithë strukturat e UNIKO-së konsiderohet përparësi për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Përvoja e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programet e studimit, organizimi i tyre.

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programeve/eve të studimit, përmbajtja e programeve, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave

⁵³ Anex VI. Dok. 6.9. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/universiteti-fan-s-noli-mori-pjes%C3%AB-n%C3%AB-nj%C3%AB-takim-n%C3%AB-kuad%C3%ABr-t%C3%AB-finalizimit-t%C3%AB-procesit-t%C3%AB>

⁵⁴ Anex VI. Dok. 6.10. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/%E2%80%9Csondazhi-kombetar-i-student%C3%ABve-2017-2018%E2%80%9D-takim-informues-nga-agjencia-e-sigurimit-t%C3%AB>

⁵⁵ Anex VI. Dok. 6.11. Organograma: <https://www.unkorce.edu.al/sq/node/706>

⁵⁶ Anex VI. Dok. 6.12. Statuti UNIKO (KREU IX) https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/STATUTI%20I%20UNIVERSITETIT%20FAN%20S.%20NOLI%20KORCE_0.pdf

të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Qëllimi themelor i FSHNH-it në fushën e mësimdhënies është transmetimi tek studentët i një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik ose praktik, duke mbajtur parasysh formimin e kompetencave të studentëve. Pra, synohet përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, si dhe të orientohen menjëherë përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.

Ky objektiv realizohet:

(1) duke përpunuar e zgjedhur programe disiplinash sa më cilësore për çdo lëndë e që zhvillohet në FSHNH;

(2) duke përdorur si literaturë bazë dhe plotësuese libra, autorë dhe shtëpi botuese nga më të spikaturat e fushës, të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar;

(3) nëpërmjet zhvillimit të leksioneve dhe seminareve me metoda e forma didaktiko-pedagogjike moderne e interaktive, duke përdorur gjerësisht prezantimet problemore, analizën logjike e sasiore, analizat krahasuese e kontekstuale, pjesëmarrjen aktive të studentëve në leksione e seminare, debatin e improvizuar, etj.

Tregues të matshëm:

☒ Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e programeve të studimit

Kurset e studimit zhvillohen në bazë të planit mësimor të miratuar në Senatin e Universitetit.

Për të siguruar një formim sa më bashkëkohor të studentëve planet mësimore janë rinovuar nga viti në vit, duke ruajtur një raport të pranueshëm midis grup lëndëve të formimit të përgjithshëm, formimit bazë, formimit special dhe lëndëve me *zgjedhje*.

Elementët që përbëjnë strukturën e programeve të studimit në UK, janë përcaktuar në aktet nënligjore dhe konstistojnë në: ^{57, 58}

- a. Kreditet sipas ECTS;
- b. Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c. Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;
- d. Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- e. Kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë një program studimi;
- f. Planin mësimor;
- g. Kuotat e pranimi dhe grupet mësimore;
- h. Programin lëndor (syllabuset);
- i. Profilin e programit;
- j. Diplomën dhe suplementin

☒ **Organizimi i programeve të studimit (vite, semestra, javë etj.)⁵⁹**

⁵⁷ Anex VII. Dok. 7.1. VKM Nr.41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 6, Datë. 25/01/2018:

<https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/6/0f1307ef-8573-422a-a092-6aa6d5e36e3e>

⁵⁸ Anex VII. Dok.7.2. Rregullorja UNIKO (NENI 80)

https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/RREGULLORE%20E%20ORGANIZIMIT%20DHE%20VEPRIMTARISE%20MESIMORE_0.pdf

Struktura për sistemin 2-vjeçar të studimit (Program Profesional) të fakultetit është si më poshtë:

Kohëzgjatja e studimeve	2 vite akademike 4 semestra 60 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	120 ECTS
Orë mësimore në auditor	1500 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1500 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin 3-vjeçar të studimit (Bachelor) të fakultetit është si më poshtë

Kohëzgjatja e studimeve	3 vite akademike 6 semestra 90 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	180 ECTS
Orë mësimore në auditor	2365 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	2260 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master Profesional ” të Fakultetit është si më poshtë:

Kohëzgjatja e studimeve	1.5 vite akademike 3 semestra 45 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	60 ECTS
Orë mësimore në auditor	1125 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1125 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

Struktura për sistemin “Master i Shkencave ” të Fakultetit është si më poshtë:

Kohëzgjatja e studimeve	2 vite akademike 4 semestra 60 javë akademike
Numri i përgjithshëm i krediteve	120 ECTS
Orë mësimore në auditor	1500 orë
Orë mësimore jashtë auditorit	1500 orë
Ngarkesa minimale javore	25 orë

☒ **Emërtimi i Diplomës për programin e studimit**

Përgjegjësit e departamenteve administrojnë programet e studimit dhe koordinojnë mësimdhënien, mësimnxënien dhe veprimtarinë kërkimore në shkallë departamenti, duke raportuar te dekani i fakultetit, i cili koordinon veprimtaritë e departamenteve.

Programet e studimit pasqyrojnë Misionin, Planin Strategjik dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit, duke synuar kryesisht përmbushjen e nevojave rajonale ekonomike dhe sociale.

Fakulteti ofron kualifikime përgjatë të dy cikleve me 8 programe Bachelor, 6 Master Profesional, 1 program Master i Shkencave dhe 1 program studimi profesional dyvjeçar pas arsimit të mesëm. Në faqen e internetit të institucionit, publikohen informacione rreth programeve të studimit, duke përfshirë informacione për strukturën e kursit, për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe për kreditet ECTS.⁶⁰

Rregulloret përkufizuese të secilit program studimi përfshijnë informacion të përgjithshëm rreth kurrikulës, mësimdhënies dhe mësim-nxënies, vlerësimit, pranimeve, infrastrukturës dhe mbështetjes, si dhe mundësive për punësim. Rregulloret dhe informacioni për çdo njësi hidhen në faqen e internetit dhe janë të disponueshme në sistemin digjital ESSE3 të universitetit⁶¹

Diplomat Profesionale

Fakulteti jep diploma për këto programe studimi profesionale dyvjeçare me emërtim:

Diplomë Profesionale dyvjeçare pas arsimit të mesëm në “Shërbim Social”⁶²

Diplomat “Bachelor”. Fakulteti jep diploma për këto programe studimi Bachelor me emërtimet:

Diploma " Bachelor" në Filozofi-Sociologji ⁶³
Diploma " Bachelor" në Administrim dhe Politika Sociale ⁶⁴
Diploma " Bachelor" në Matematikë Informatikë ⁶⁵
Diploma " Bachelor" në Matematikë-Fizikë ⁶⁶
Diploma " Bachelor" në Teknologji Informacioni ⁶⁷
Diploma " Bachelor" në Biologji-Kimi ⁶⁸
Diploma " Bachelor" në Infermieri e Përgjithshme ⁶⁹
Diploma “Bachelor” në Mami/Infermieri

Diplomat “Master Profesional”. Fakulteti jep diploma për këto programe studimi “Master Profesional” me emërtimet:

⁶⁰ Anex VII. Dok. 7.4. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

⁶¹ Anex VII. Dok.7.5. Rregullore ESSE3

http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/Rregullore%20per%20ESSE3_%20update%2019_4_2017.pdf

⁶² Anex VII. Dok.7.6. Urdhër. 374, datë 05.07.2018

⁶³ Anex VII. Dok. 7.7. VKM. nr. 22007/2, datë 16. 06. 2002

⁶⁴ Anex VII. Dok. 7.8. VKM. nr. 3167/2, datë 04.04.2013

⁶⁵ Anex VII. Dok. 7.9. VKM. nr. 833, datë. 04.06.2008

⁶⁶ Anex VII. Dok. 7.10. VKM. nr.833, datë 04.06.2008

⁶⁷ Anex VII. Dok. 7.11. VKM. nr.518, datë 30. 06. 2010

⁶⁸ Anex VII. Dok. 7.12. VKM. nr.352, datë 12.05.2010

⁶⁹ Anex VII. Dok. 7.13. VKM. nr.3629, datë 10. 07. 1995

Diploma “Master profesional” Mësuesi për shkollat e mesme në Shkenca Sociale ⁷⁰
Diploma “Master profesional” Mësues në Biologji-Kimi ⁷¹
Diploma “Master profesional” Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë ⁷²
Infermieristikë ⁷³
Sistemet moderne te TI
Administrim Publik

Diplomat “Master i Shkencave” .Fakulteti jep diploma për këto programe studimi “Master i Shkencave” me emërtimet:

Diploma “Master i Shkencave” në Filozofi Sociale ⁷⁴
--

☒ **Plani mësimor**

Planet mësimore për çdo program studimi jepen të detajuara në faqen zyrtare të UNIKO dhe fakultetit përkatës⁷⁵. Ato parashikojnë:

Kodin e disiplinës

Emërtimin e lëndës /modulit

Kodin

Vitin akademik

Orët gjithsej (të ndara në leksione dhe seminare)

Orët për dtudim individual të studentit

Deyra, projekte , laboratore apo praktika

Detyrimin për lëndën

Ndarjen sipas semestrit

Numrin e krediteve të cilat hidhen në formatin e tabelës më poshtë. ^{76;77;78;79}.

Tabela 10. Shembull i formatit të tabelës për detajimin e planit mësimor të programit të studimit.

Viti I (Viti II) (Viti III) Lëndë/Module		Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Provime			
					Leksione			Seminare			Laborator			Praktikë				Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e Pavarur				
1	Lënda 1																			
2	Lënda 2																			

⁷⁰ Anex VII. Dok. 7.14. Urdhër. nr. 398, date 07.10.2014

⁷¹ Anex VII. Dok. 7.15. VKM. nr.744, datë 05.09.2013

⁷² Anex VII. Dok. 7.16. VKM. nr.

⁷³ Anex VII. Dok. 7.17. Urdhër. 177, datë 06.05.2015

⁷⁴ Anex VII. Dok. 7.18. VKM. Nr. 351, datë 12.05.2010

⁷⁵ Anex VII. Dok. 7.19. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

⁷⁶ Anex VII. Dok. 7.20. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-programe-profesionale>

⁷⁷ Anex VII. Dok. 7.21. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-bachelor>

⁷⁸ Anex VII. Dok. 7.22. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-master-profesional>

⁷⁹ Anex VII. Dok.7.23. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit-master-i-shkencave>

3	...																		
	Totali		60																

- ☒ Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit, ndarja e orëve në auditor dhe jashtë auditorit për leksione, seminare, laboratore, praktika apo provime, detajohet nga secili pedagog në sylabusin e lëndës:⁸⁰

☒ **Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F)**

Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
- v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.⁸¹ sipas shembullit të mëposhtëm:

Tabela 11. Shembull i grupimit të veprimtarive formuese sipas kategorive

TIPI I VEPRIMTARISË DHE SIMBOLI PËRCAKTUES PËR TË	FUSHAT DISIPLINORE APO VEPRIMTARI TË TJERA FORMUESE	KREDITE	TOTALI I KREDITEVE
LËNDË BAZË -kulturë e përgjithshme (Simboli: A)	Hyrje në ekonomi	6	24 ECTS
	Logjikë	8	
	Histori Kombëtare	5	
	Bazat e së Drejtës	5	
LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	Hyrje në Filozofi	9	
	Hyrje në Sociologji:		
	a. Hyrje në Sociologji b. Teoritë Sociologjike	9 6	

⁸⁰ Anex VII. Dok. 7.22. Model i planit mësimor të programeve të studimit.

⁸¹ Anex VII. Dok. 7.23. VKM Nr.41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë- Shtojca nr.1. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 6, Datë. 25/01/2018:
<https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/6/0f1307ef-8573-422a-a092-6aa6d5e36e3e>

(Simboli: B)	Historia e Filozofisë I (Antikiteti)	5	102 ECTS
	Historia e Filozofisë I (Mesjeta)	5	
	Sociologji Kulture	9	
	Filozofi Morale dhe e Fesë:		
	a. Filozofia Morale	4	
	b. Filozofia e Fesë	4	
	Historia e Filozofisë II	9	
	Sociologji Politike	9	
	Antropologji	9	
	Sociologji Urbane	9	
	Historia e Filozofisë shek. XX	9	
	Fenomenologji	6	
LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (Simboli: C)	Psikologji	6	22 ECTS
	Metodologjia e kërkimit	8	
	Mendimi politik shoqëror shqiptar	8	
LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale Simboli: D)	Gjuhë e huaj (Anglisht)	7	25 ECTS
	Informatikë	5	
	Filozofi Arti	6	
	Sociologji familje	6	
DETYRIME PËRMBYLLËSE (Simboli: E)	Mikrotezë diplome	8	8 ECTS
Totali			180ECTS

Tabela 12. Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar (Praktike model)

☒ Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programin e licensuar (Tabela 12)

Bazuar në ligjin për arsimin e lartë nr. 80\2015 Departamenti i Infermierisë për realizimin e programit mësimor në përputhje me Rregulloren e Universitetit dhe me kërkesat e reja shkencore të domosdoshme ka propozuar ndryshimet e mëposhtme për programin e studimit të ciklit të parë bachelor, me kohë të plotë viti akademik 2019-2020. Këto propozime u parashtruan dhe në mbledhjen e Departamentit të Infermierisë.

Në tabelën 12 paraqiten ndryshimet e realizuara:

Viti I (Viti II) (Viti III) Lëndë/Module		Viti	Semestri	ECTS
1	(ishte)	1	1	2
	<i>Biologji</i>	1	1	2
	<i>Biofizike</i>	1	1	2
	<i>Biokimi</i>			

	(u ndryshua) Biologji (lende me zgjedhje) Biofizike (lende me zgjedhje) Biokimi (lende me zgjedhje)	1 1 1	1 1 1	2 2 2
2	(ishte) Etike	1	1	2
	(U ndryshua) Etike	1	1	3
3	(ishte) Radiologji - imazheri	2	2	3
	(U ndryshua) Radiologji - imazheri	2	2	2
4	(ishte) Urgjenca infermierore	2	2	1
	(U ndryshua) Urgjenca infermierore	2	2	2
5	(ishte) K. Inf. Sem e Brendshme	3	2	1
	(U ndryshua) K. Inf. Sem e Brendshme	3	2	1
6	(ishte) Kirurgji Speciale	3	1	3
	(U ndryshua) Kirurgji Speciale	3	1	5
7	(ishte) K. Inferm. Kirurgjikal 3.1	3	1	2
	(U ndryshua) K. Inferm. Kirurgjikal 3.1	3	1	3
8	(ishte) K. Inferm. Kirurgjikal 3.2	3	2	2
	(U ndryshua) K. Inferm. Kirurgjikal 3.2	3	2	3
9	(ishte) K. Inferm. Obstetrike gjinekologji	3	2	1
	(U ndryshua) K. Inferm. Kirurgjikal 3.1	3	2	2
10	(ishte) K. Inferm. Pediatrik	3	1	1
	(U ndryshua) K. Inferm. Pediatrik	3	1	2
11	(ishte) ORL Okulistike	3	2	3
	(U ndryshua) ORL Okulistike (Lende me Zgjedhje)	3	1	3
12	(ishte) Semundje Infektive	3	1	4
	(U ndryshua) Semundje infektive	3	1	3
13	(ishte) Kujdes. Semundje Infektive	3	1	1
	(U ndryshua) Kujdes Semundje infektive	3	1	2
14	(ishte) Dermatologji	3	2	2
	(U ndryshua) Dermatologji (Lende me Zgjedhje)	3	2	3
15	(ishte) Metodologji kerkimi	3	2	2

	(U ndryshua) Metodologji kerkimi	3	2	3
16	(ishte) K. Inferm. Neurologji	3	2	1
	(U ndryshua) K. Inferm. Neurologji	3	2	2
17	(ishte) K. Inferm. Geriatrik	3	2	1
	(U ndryshua) K. Inferm. Geriatrik	3	2	2
18	(ishte) Geriatri	3	2	2
	(U ndryshua) Geriatri	3	2	3

Argumentim: Ndryshimet kërkohen për plotësimin sa më të mirë të mundshëm të programit të studimit për lëndët e mësipërme koherent me kërkesat e reja.

Ndryshimet kërkohen në mënyrë që programi mësimor të jetë në përputhje me Rregulloren e Universitetit dhe legjislacionin në fuqi.

Ndryshimet kërkohen edhe për plotësimin sa më të mirë të mundshëm të programit të studimit për lëndët e mësipërme si dhe balancimit të orëve me kreditet.

Ndryshimet kërkohen për përafrimin sa më të mirë të mundshëm të programit të studimit në përqindjen që parashikon ligji për arsimin e lartë me programe të studimit të ngjashme në universitetet e tjera si brenda dhe jashtë vendit.

Ndryshimet kërkohen në mënyrë që programi mësimor të jetë në përputhje me kërkesat bashkëkohore për punësim nga subjektet private dhe shtetërore për infermierë dhe mami.

Ndryshimet kërkohen në mënyrë që programi mësimor të jetë në përputhje me kërkesat për studime të nivelit të dytë për disa drejtime të fushës.

Tabela 13. Model plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës

Për secilin program studimi, në rregullore plotësohet edhe plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës⁸² sipas shembullit të mëposhtëm.

Viti akademik 2019-2020 Matematikë-Informatikë						
Lënda /Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1.	Analiza 1.	Lorenc Ekonomi	Prof. Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
2.	Algjebra 1.	Eljona Milo	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
3.	Gjeometri Analitike 1.	Argjir Butka	Dr.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
4.	Matematikë Elementare	Silvja Çobani	MSc.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
5.	Informatika 1.	Dhori Beta	MSc.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
6.	Fizika 1.	Sotiraq Marko	MSc.	Mat-Inf-Fiz	70	PAE

⁸² Anex VII. Dok. 7.24. Rregulloret e studimeve sipas ciklit dhe degëve. Planu mësimor i lidhur me personelin akademik

7.	Anglishte e Përgjithshme	Ermenita Çuka	MSc.	Gjuhët e Huaja	38	PAE
8.	Analiza 2.	Lorenc Ekonomi	Prof. Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
9.	Algjebra 2.	Edlira Donefski	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
10.	Gjeometri Analitike 2.	Arto Adili	Dr.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
11.	Gjeometri Elementare	Arto Adili	Dr.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
12.	Informatika 2.	Dhori Beta	MSc.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
13.	Fizika 2.	Sotiraq Marko	MSc.	Mat-Inf-Fiz	70	PAE
14.	Anglishte Profesionale	Ermenita Çuka	MSc.	Gjuhët e Huaja	38	PAE
					742 (332 Leks.+ 390 Sem. + 20 Lab.)	
15.	Analiza 3.	Danjela Braho	Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
16.	Algjebra 3.	Eljona Milo	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
17.	Teoria e Numrave	Arto Adili	Dr.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
18.	Informatika 3.	Emis Simo	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
19.	Fizika 3.	Lorena Kelo	MSc.	Mat-Inf-Fiz	70	PAE
20.	Sisteme Shfrytëzimi	Marijon Pano	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
21.	Logjikë Formale Filozofi	Magdalini Vampa Mitjana Profiri	Dr. MSc.	Shkenca Soc Shkenca Soc	30 30	PAE PAE
22.	Analiza 4.	Danjela Braho	Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
23.	Algjebra 4.	Eljona Milo	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
24.	Gjeometri e Lartë	Lorena Margo	Dr.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
25.	Matlab	Argjir Butka	Dr.	Mat-Inf-Fiz	38	PAE
26.	Fizika 4.	Esmeralda Guliqani	MSc.	Mat-Inf-Fiz	70	PAE
27.	Rrjeta Kompjuterike	Erma Pema	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
28.	POO	Marijon Pano	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
					744 (377 Leks. + 347 Sem. + 20 Lab.)	
29.	TFNK	Danjela Braho	Dr.	Mat-Inf-Fiz	45	PAE
30.	Probabiliteti	Lorenc Ekonomi	Prof. Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
31.	Analizë e Lartë* Analizë Funksionale*	Lorena Margo Lorenc Ekonomi	Dr. Prof. Dr.	Mat-Inf-Fiz	53 53	PAE PAE
32.	Web Design	Rafail Prodani	Dr.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
33.	Bazë të Dhënash	Blerina Çeliku	Dr.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
34.	Bazat e Elektronikës	Marsel Kotori	MSc.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
35.	Programim në Java	Blerina Çeliku	Dr.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE
36.	Ekuacione Diferenciale	Edlira Donefski	MSc.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
37.	Statistikë Matematike	Argjir Butka	Dr.	Mat-Inf-Fiz	53	PAE

38.	Matematikë e Zbatuar	Edlira Donefski	MSc.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
39.	SPSS	Lorena Margo	Dr.	Mat-Inf-Fiz	38	PAE
40.	Arkitekturë Kompjuteri	Erma Pema	MSc.	Mat-Inf-Fiz	60	PAE
41.	Kriptografi* Siguri Sistemes* [*]	Blerina Çeliku	Dr.	Mat-Inf-Fiz	38 38	PAE
					686 (346 Leks.+ 340 Sem.)	
42.	Temë Diplome					

Syllabus-et për çdo lëndë

Për secilën lëndë/ modul hartohen sylabueset e saj me elemente standarde të përcaktuara me VKM.⁸³

Syllabuset përmbajnë këto elemente⁸⁴:

I

Titullari /pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, grada shkencore dhe nënshkrimi)

Ngarkesa: (numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion dhe seminar, praktika etj.)

Tipologjia e lëndës:

Viti akademik/semestri kur zhvillohet:

Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)

Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:

II

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit. Objektivat e lëndës janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të cilat ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritët të përvetësojë në përfundim të lëndës)

III

KONCEPTET THEMELORE: (janë koncepte e terma bazë mbi të cilat ndërtohet lënda)

- 1.
- 2.
3. ...

IV

TEMAT E LËNDËS shpjegimi (rreth një paragrafi) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe)

Tema I –

⁸³ Anex VII. Dok. 7.25. VKM Nr.41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë- Shtojca nr.2. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 6, Datë. 25/01/2018: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/6/0f1307ef-8573-422a-a092-6aa6d5e36e3e>

⁸⁴ Anex VII. Dok. 7.26. Rregulloret e programeve të studimit për çdo cikël- Syllabuset

Tema II –
Tema III –
.....

V

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE FREKUENTIMI: KONTROLI I VAZHDUESHËM: (renditen format e vlerësimit të studentëve të shprehura si përqindje e notës përfundimtare: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra e kursit dhe provimi përfundimtar etj.)

VI

LITERATURA (literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në) a) Literatura bazë e detyrueshme: b) Literatura e rekomanduar: VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS (hapësira ku pedagogu parashtro mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka)

Shembull i një modeli sylabusi jepet në tabelën e mëposhtme.

PROGRAMI I LËNDËS “METODAT E KËRKIMIT NË EDUKIM”

Pedagogu i lëndës: Dr. Magdalini Vampa

Ngarkesa: 5 kredite, 30 orë leksion dhe 30 orë seminar; 65 orë punë e pavarur (35 orë provimi final, 30 orë projekti semestral)

Tipologjia e lëndës: C

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: 2019-2020 /Viti I/ Semestri I

Lloji i lëndës: E detyrueshme

Programi i studimit: Master profesional “Mësues në Shkenca sociale”

Kodi i lëndës:

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: magdagaqollari@yahoo.com

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Moduli “Metodat e kërkimit në edukim” do të thellojë njohjen mbi kërkimin shkencor në fushën e shkencave të edukimit, duke theksuar kërkimin si proces të vazhdueshëm dhe sistematik. Studentët duhet të arrijnë të kuptojnë se informacioni dhe kërkimi nuk ekzistojnë në zbrazëti, por janë pjesë e një tërësie të madhe ku përfshihen mënyra si mendojmë për veten dhe për botën shoqërore, idetë dhe teoritë, si dhe aspektet më praktike si: hartimi i instrumentave të matjes, mbledhja dhe analiza e të dhënave.

Pjesëmarrësit do të përdorin bazat teorike, për të realizuar shqyrtimin kritik të literaturës që lidhet me fushën e interesit të tyre dhe të jenë të vetëdijshëm mbi dobinë e rezultateve të kërkimit shkencor në përmirësimin e të kuptuarit të praktikës së punës, mjedisit social, etj.

Konkretisht përmes leksioneve, seminareve dhe praktikave të lëndës studentët do të jenë të aftë të identifikojnë problemin e kërkimit dhe të hartojnë hapa në realizimin e procesit të kërkimit.

Në përfundim të kësaj lënde studenti:

Do të kuptojë dhe përdorë terminologjinë e kërkimit shkencor

Do të jetë i vetëdijshëm për parimet etike të kërkimit

Të njohë metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit shkencor.

Të identifikojë komponentët e shqyrtimit të literaturës.

Të njohë elementët e hartimit të një devize kërkimi.

Të dijë si të hartojë instrumenta të matjes.

Të analizojë në mënyrë kritike hulumtimet e publikuara, si artikuj apo monografi.

Të realizojë një projekt kërkimi shkencor duke respektuar etapat e një metode shkencore sipas fushave të tij të interesit.

KONCEPTET THEMELORE:

Kërkim shkencor, metodë sasiore, metodë cilësore, shqyrtim i literaturës, devizë kërkimi, problem i kërkimit, hipotezë, kampionim, instrumenta të matjes, analizë dhe interpretim i të dhënave, etj

Java I. Kërkimi shkencor.

Hulumtimi shkencor.

Metodat tradicionale për të njohur dhe rëndësia e saj për disiplinat shkencore dhe profesionet.
Lidhjet ndërmjet kërkimit, teorisë dhe praktikës.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 9-24

Java II. Themelet filozofike të kërkimit shkencor.

Përcaktimi i termave lidhur me kërkimin shkencor.

Etapat e procesit të kërkimit.

Faza konceptuale.

Faza metodologjike.

Faza empirike.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 24-37

Java III.**Problemi i kërkimit.**

Çështjet kërkimore.

Përcaktimi i tipeve të çështjeve sipas nivelit të njohjes.

Elementët e formulimit të një problemi kërkimor.

Argumentimi tek problemi i kërkimit.

Etapat e formulimit të problemit kërkimor.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 38-69

Java IV.**Recensionit i shkrimeve.**

Përcaktimi i qëllimit të recensionit.

Organizimi dhe redaktimi i informacionit.

Kuadri i referencës dhe niveli i kërkimit.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 70-95

Java V.**Qëllimi në kërkim dhe hipotezat.**

Qëllimi i studimit dhe niveli i njohjes.

Hipotezat.

Verifikimi i hipotezave.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 96-108

Java VI.**Deviza e kërkimit (plani kërkimor).**

Përcaktimi i qëllimit të devizës së kërkimit.

Elementët e devizës së kërkimit.

Klasifikimi i kërkimeve dhe nivelet e njohjes.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq. 109-122

Java VII. Natyra e të dhënave. Matja e koncepteve. Masa e koncepteve. Rrugët e matjes. Shkalla e masës. Gabimi i masës. Gj. Pendavinji, “<i>Metodologjia e Kërkimit</i>”, Korçë 2002, fq.123-141
Java VIII. Metodat e hulumtimit. Karakteristikat e tipit deskriptiv. Tipat e studimeve deskriptive. Metodat dhe analizat. Studime të tipit korrelativ. Tipat e studimeve korrelativë. Rendi hierarkik i devizave korrelative. Studime të tipit eksperimental. Variablat eksperimentale. Kategoritë e studimeve të tipit eksperimental. Devizat kuazieksperimentale. Devizat paraeksperimentale. Gj. Pendavinji, “<i>Metodologjia e Kërkimit</i>”, Korçë 2002, fq.142-172
Java IX. Kampioni. Koncepte të përgjithshme mbi kampionin. Kampionet probabilitare dhe ato joprobabilitare. Madhësia e kampionit. Gj. Pendavinji, “<i>Metodologjia e Kërkimit</i>”, Korçë 2002, fq.173-194
Java X. Mbledhja e të dhënave. Metoda e mbledhjes së të dhënave. Shprehitë e mbledhjes së të dhënave. Pyetsorët. Intervistat. Vrojtimi. Dokumentet. Burimet dytësore të të dhënave. Gj. Pendavinji, “<i>Nga mbledhja e të dhënave tek analiza statistikore e të dhënave</i>”, Korçë 2008, fq. 17-69
Java XI. Analiza e të dhënave. Tiparet e analizave. Analiza tematike. Analiza e rëfimeve. Analiza e ligjëritimit. Analiza e përmbajtjes. Teoria e bazuar. Gj. Pendavinji, “<i>Metodologjia e Kërkimit</i>”, Korçë 2002, fq.210-225.
Java XII. Përdorimi i programeve kompjuterike në analizimin e të dhënave. Analiza statistikore. Si të përdorim SPSS. Kodimi i të dhënave.

Gj. Pendavinji, “*Nga mbledhja e të dhënave tek analiza statistikore e të dhënave*”, Korçë 2008
Fq. 70-133

Java XIII.

Nxjerja e përfundimeve.

Paraqitja e rezultateve.

Interpretimi i rezultateve.

Përgjithësimi i rezultateve.

Audienca dhe qartësia.

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002, fq.226-239

Java XIV.

Etika në kërkim.

Etika në punën hulumtuese.

Privatësia e të dhënave.

Grupet e rezikuara.

Sjellja e paligjshme.

Kodi i Nurembergut. Plagjiatura.

Gj. Pendavinji, “*Nga mbledhja e të dhënave tek analiza statistikore e të dhënave*”, Korçë 2008

Fq.144-166

Java XV.

Bibliografia. Të shkruarit. Raportet dhe temat e diplomës.

Procesi i të shkruarit.

Rregullat e të shkruarit. Raporti.

Temat e diplomes

B. Matthews, L. Ross, “*Metodat e Hulumtimit*”, CDE, Tiranë 2010, 105-109, 430-451

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI: jo më pak se 75% të orëve

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Kolokuium: 30%

Projekte : 40%

Detyra të tjera: 30%

Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit.

LITERATURA

Literatura bazë e detyrueshme:

Gj. Pendavinji, “*Metodologjia e Kërkimit*”, Korçë 2002.

Gj. Pendavinji, “*Projekti i kërkimit në shkencat sociale*”, Korçë 1997.

Gj. Pendavinji, “*Nga mbledhja e të dhënave tek analiza statistikore e të dhënave*”, Korçë 2008.

Literatura e rekomanduar:

B. Matthews, L. Ross, “Metodat e Hulumtimit”, CDE, Tiranë 2010.
 L. Cohen, “Research Methods in Education”, 5th Edition, Lawrence Manion and Keith Morrison, London 2000.
 P. Corbetta, “Social Research: Theory, methods and techniques”, Sage, London 2003.
 F. N. Kerlinger, “Foundations of Educational Research”, Holt, Reinhart and Qwinston, New York 1970.
 C. Pole, R. Lampard, “Practical Social Investigation: Qualitative and Quantitative Methods in Social Research”, Pearson Education, Harlow 2002.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	UNIKO është institucion i akredituar për një periudhë 5 vjeçare⁸⁵. Programet që ofrohen në FSHNH janë programe të licensuara me VKM ose Urdhër të MASR-së.⁸⁶ Programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MASR-ja dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë.⁸⁷
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II.4 - Programet e studimit të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	

⁸⁵ Anex VII. Dok. 7.27. <https://www.unkorce.edu.al/sq/article/akreditimi-institucional>

⁸⁶ Anex VII. Dok. 7.28. Dokument përmbledhës që përmban VKM apo Urdhër të hapjes të programeve të studimit të FSHNH në UNIKO

⁸⁷ Anex VII. Dok. 7.29. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve

Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve; Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër; Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programeve; Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.	Programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Ato janë të afishuara në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu gjenden edhe në faqen e internetit të UNIKO sipas fakulteteve përkatëse.⁸⁸ Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar. Kjo gjë është e parashikuar dhe në syllabuset e lëndëve.⁸⁹
Konkluzionet e GVB: GVB vlerëson se studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Çdo fillim viti atyre u vihet në dispozicion program i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe afishohen nga departamenti në vende të dukshme. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit www.unkorce.edu.al Konstatohet një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra dhe nga njëri vit në tjetrin. Lëndët gjithashtu janë të organizuara në tipologji, ku lëndët e një karakteri të mirëfilltë teorik kanë më shumë leksione në auditor, ndërsa lëndët me karakter praktik kanë ngarkesë më të lartë të orëve të seminarit dhe orëve për projekte/detyra/ushtime. Ky organizim shërben për të rritur nivelin e mësimnxënies së studentëve, pasi lehtëson përvetësimin e informacionit, duke iu përshtatur natyrës së lëndës.	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të studimit, të ofruara nga IAL-të, konsistojnë në:

- a) kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);
- b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;
- c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale;
- ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;
- d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;
- dh) planin mësimor;
- e) programin lëndor (Syllabus-et);
- ë) kreditet sipas ECTS-së

⁸⁸ Anex VII. Dok. 7.30. <https://www.unkorce.edu.al/sq/programet-e-studimit>

⁸⁹ Anex VII. Dok. 7.31. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve . Model syllabusi për lëndën për secilin cikël studimi

Një krediti i korrespondojnë 25 (njëzet e pesë) orë mësimore pune të studentit. Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh, nga një student me kohë të plotë, është 60 (gjashtëdhjetë) kredite ose 1 500 (një mijë e pesëqind) orë mësimore pune të studentit, të cilat përfshijnë orë në auditor dhe orë pune të pavarur të tij. Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (një mijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe. Kreditet korresponduese për çdo veprimtari formuese fitohen nga studentët vetëm për vlerësim pozitiv, në verifikimin përfundimtar të dijeve të fituara prej tyre. Për vlerësimin e dijeve të përfituara përdoren forma të ndryshme kontrolli, që kombinojnë vlerësimin e vazhdueshëm me atë përfundimtar (i cili mund të jetë provim, por jo vetëm).

Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studentët. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:

- i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor;
- ii) ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh;
- iii) iii) përgatitje për provime;
- iv) iv) përgatitje e tezës së diplomës;
- v) v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private.

Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, në bazë të krediteve që ka secila disiplinë.

Studentëve, në përfundim të programit të studimit, u përlllogaritet nota mesatare e ponderuar, që merr në konsideratë edhe kreditet respektive për çdo disiplinë apo veprimtari tjetër formuese.

Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS.

Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- i) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- ii) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- iii) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje;
- iv) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfundimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që

lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;

- v) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.

Veprimtaritë formuese mund të jenë:

- i) të detyrueshme;
- ii) të zgjedhura nga vetë studentët, ndërmjet atyre të ofruara nga institucioni, dhe koherente me

programin e studimit, të realizuara këto gjatë viteve akademike të programit të studimit.

Tregues të matshëm:

Tabela 14. Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies në programet e studimit.

Programi i Studimit Profesional :Shërbim Social	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	614
Seminare	586
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	250
Studim individual	1450
Në total	2900

Programi i Studimit Mat. – Fiz.	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1077
Seminare	1055
Ushtrime	-
Laboratore	40
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	-
Pune Individuale (Lek.+Sem.)	2132
Në total	4304

Programi i Studimit : Bachelor “Filozofi-Sociologji”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1250
Seminare	885
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	-

Studim individual	2365
Në total	4500

Programi i Studimit :Bachelor “Administrim dhe Politika Sociale”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1255
Seminare	925
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	-
Studim individual	2300
Në total	4480

Programi i Studimit Tek. Informacioni	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1052
Seminare	1077
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	-
Pune Individuale (Lek.+Sem.)	2129
Në total	4258

Programi i Studimit Biologji-Kimi	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1037
Seminare	
Ushtrime	471
Laboratore	579
Praktikë lëndore	125
Praktikë profesionale	
Etj	40
Në total	2252

Programi i Studimit Infermier i pergjithshem	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1225
Seminare	197
Ushtrime	-
Laboratore	267
Praktikë lëndore (klinike)	455
Praktikë profesionale	

Studim individual	2011
Në total	4155

Programi i Studimit Mami	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	1219
Seminare	169
Ushtrime	-
Laboratore	349
Praktikë lëndore (klinike)	362
Praktikë profesionale	
Studim individual	2043
Në total	4142

Programi i Studimit Master profesional “Mësuesi për arsimin e mesëm në Shkenca Sociale”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	650
Seminare	380
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	150
Studim individual	1060
Në total	2240

Programi i Studimit Master profesional “Administrim Publik”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	435
Seminare	165
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	75
Studim individual	825
Në total	1500

Programi i Studimit Master profesional në Infermieristikë	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	652
Seminare	313
Ushtrime	-
Laboratore	-
Praktikë lëndore	-

Praktikë profesionale	200
Studim individual	1205
Në total	2337

Programi i Studimit Master Prof. Mat. Fiz. Min. Informatikë		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	599
b.	Seminare	243
c.	Ushtrime	-
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	240
g.	Studim Individual	842
	Në total	1924

Programi i Studimit Master Prof. TI		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	400
b.	Seminare	273
c.	Ushtrime	-
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	240
g.	Studim Individual	673
	Në total	1586

Programi i Studimit master Profesional Mësues në Biologji-Kimi		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	494
b.	Seminare	327
c.	Ushtrime	
d.	Laboratore	55
e.	Praktikë lëndore	
f.	Praktikë profesionale	125
g.	Teza	125
	Në total	1126

Programi i Studimit Master shkencor “Filozofi Sociale”		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
	Leksione	665
	Seminare	355
	Ushtrime	-
	Laboratore	-

Praktikë lëndore	-
Praktikë profesionale	100
Studim individual	1880
Në total	3000

Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, performancave artistike, praktikave dhe tezave të diplomave. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritët të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Pësia e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin përfundimtar qëndron në raportet 30% me 70%. Elementet specifike dhe pësia që zënë ato në vlerësimin e vazhduar përshkruhen në sylabuset e lëndëve nga secili pedagog dhe miratohet që në fillim të vitit nga përgjegjësi i departamentit i cili miraton këtë sylabus. Këto raporte ndryshojnë në varësi të llojit të lëndës dhe programit të studimit.^{90;91}

Tabela 15. Aktivizimi i studentëve në aktivitete të njësise

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve ⁹²	13
Për projekte shkencore në rang Departamenti ^{93; 94}	20
Për projekte shkencore në rang Fakulteti ^{95;96;97}	60
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	-

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

⁹⁰ Anex VII. Dok. 7.32. Rregulloret e programeve të studimit sipas degëve . Model sylabusi për lëndën për secilin cikël studimi

⁹¹ Anex VII. Dok. 7.33. VKM Nr.41, datë 24.1.2018 Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë- Shtojca nr.2. Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr. 6, Datë. 25/01/2018: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/6/0f1307ef-8573-422a-a092-6aa6d5e36e3e>

⁹² Anex VII. Dok. 7.34. Dokument i sekretarisë: Studentë që e kanë mbyllur ciklin e studimit me temë diplome

⁹³ Anex VII. Dok. 7.35. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/student%C3%ABt-e-uniko-marrin-p%C3%ABrvoja-t%C3%AB-reja-gjat%C3%AB-pjes%C3%ABmarrjes-n%C3%AB-forumin-rinor-t%C3%AB-programit->

⁹⁴ Anex VII. Dok. 7.36. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/%E2%80%9CCarritje-dhe-sfida-n%C3%AB-sh%C3%ABrbimet-psiko-sociale-n%C3%AB-shqip%C3%ABri%E2%80%9D-konferenc%C3%AB-shkencore-organizuar>

⁹⁵ Anex VII. Dok. 7.37. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/student%C3%ABt-e-uniko-pjes%C3%ABmarr%C3%ABs-n%C3%AB-konferenc%C3%ABn-ballkanike-t%C3%AB-sofjes>

⁹⁶ Anex VIII. Dok. 8.1. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/%E2%80%9Cstudent%C3%ABt-drejt-k%C3%ABrkimit-shkencor%E2%80%9D-konferenc%C3%AB-studentore-me-punime-t%C3%AB-student%C3%ABve-t%C3%AB-0>

⁹⁷ Anex VIII. Dok. 8.2. <https://www.youtube.com/watch?v=rwZsNU4WV08>

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në programet e studimit, të ofruara në FSHNH, pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

- Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;
- Dorëzojnë dokumentet e nevojshme sipas përcaktimeve të fakultetit;
- Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të FSHNH-it;
- Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASR, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Të kryejnë pagesën e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të vendosura nga SA;

Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe realizohet nga komisioni i ngritur pranë Departamentit

Në FSHNH ofrohen lloje të ndryshme bursash, si bursa sociale për shtetasit në nevojë, bursa të pjesshme, bursa ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve etj.⁹⁸

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
Kriteri 1 Pranimi i studentëve ciklin përkatës të studimeve bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Renditja e kandidatëve fitues, bazohet në Nenin 76, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe realizohet nga komisioni i ngritur pranë Departamentit.⁹⁹ Në raste e degë të caktuara departamentet vendosin kriteret shtesë për pranimin e kandidatëve. Të gjitha kriteret bëhen publike për kandidatët¹⁰⁰ dhe janë të shpallura në fagen zyrtare të institucionit.¹⁰¹
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimeve;	Para periudhës së aplikimit për regjistrim FSHNH vë në dispozicion të maturantëve të

⁹⁸ Anex VIII. Dok. 8.3. <https://www.unkorce.edu.al/sq/pranime-ne-universitet>

⁹⁹ Anex VIII. Dok. 8.4. Shembull i praktikës së ngritjes dhe funksionimit të Komisionid *ad hoc* pranë Departamenteve për renditjen e kandidatëve fitues në programet e studimit..

¹⁰⁰ Anex VIII. Dok. 8.5. Fletëpalosje për informimin e maturantëve.

¹⁰¹ Anex VIII. Dok. 8.6. <https://www.unkorce.edu.al/sq/pranime-ne-universitet>

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit; Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës; Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.	interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh, sipas një grafiku, të cilët japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen e tyre, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të studimeve në institucione të tjera brenda ose jashtë vendit. Në fakultet organizohen edhe ditë të hapura me maturantët për të informuar rreth programeve të stusimit, këshillimit të karrierës dhe mundësitë për punësim pas diplomimit¹⁰² si dhe veprimtari të ndryshme promovuese për programet e studimit.^{103;104} Departamentet nëpërmjet veprimtarive konkrete bashkëpunuese me shkolla të mesmë të qytetit realizojnë promovimin e fakultetit dhe programeve që ofron ai.¹⁰⁵ Të gjitha kriteret bëhen publike për kandidatët dhe janë të shpallura në faqen zyrtare të institucionit¹⁰⁶. Studentët kanë mundësi për të bërë vlerësimin e pedagogëve për elemente të cilësisë së mësimdhënies, komunikimit etj, nëpërmjet pyetësorit studentor që zhvillohet në mënyrë anonime dhe online prej tyre sipas një kalendarit veprimtarish¹⁰⁷. Studentët bëhen pjesë e takime informuese nga ASCAL lidhur me sondazhin kombëtar të studentëve.¹⁰⁸
Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin Programet e studimit të ciklit të parë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë; Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në Programet e studimit të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programeve apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve; Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programeve të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.	Në UNIKO është ngritur Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit, ku Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikës dhe Sektori Juridik dhe Arkiv-Protokollit janë përgjegjës për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, duke u koordinuar me Sekretaritet Mësimorë të fakulteteve dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës. Universiteti mban rekorde të detajuara në lidhje me studentët e

¹⁰² Anex VIII. Dok. 8.7. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/universiteti-%E2%80%9Cfan-s-noli%E2%80%9D-takime-me-maturant%C3%ABt-p%C3%ABr-k%C3%ABshillimi-e-karrier%C3%ABs>

¹⁰³ Anex VIII. Dok. 8.8. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/departamenti-i-gjuh%C3%ABve-t%C3%AB-huaja-veprimtari-p%C3%ABr-promovimin-e-programit-t%C3%AB-studimit-kultur%C3%AB>

¹⁰⁴ Anex VIII. Dok. 8.9. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/k%C3%ABshillimi-i-karrier%C3%ABs-rektori-i-universitetit-t%C3%AB-kor%C3%A7%C3%ABs-prof-dr-ali-jashari-i-ftuar-nga>

¹⁰⁵ Anex VIII. Dok. 8.10. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/departamenti-i-histori-gjeografis%C3%AB-promovon-universitetin-n%C3%ABp%C3%ABr-mjet-veprimtarive-t%C3%AB>

¹⁰⁶ Anex VIII. Dok. 8.11. <https://www.unkorce.edu.al/sq/pranime-ne-universitet>

¹⁰⁷ Anex VIII. Dok. 8.12. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/2017-2018%20PLANI%20SKSC.pdf>

¹⁰⁸ Anex VIII. Dok. 8.13. <https://www.unkorce.edu.al/content/%E2%80%9Csondazhi-kombetar-i-student%C3%ABve-2017-2018%E2%80%9D-takim-informues-nga-agjencia-e-sigurimit-t%C3%AB>

	regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për program studimi. ¹⁰⁹ Zyra e Karrierës dhe Praktikave mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre. ^{110;111112}
Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor; Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Qendra e Karrierës dhe Alumni ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Qendra e Karrierës dhe Alumni është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm.¹¹³ Kjo zyrë ka tagrin për të krijuar kontakte të shumta me kompani dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.^{114, 115} QKA gjurmon studentët lidhur me punësimin e tyre apo vazhdimin e programeve të cikleve pasardhëse¹¹⁶
Konkluzionet e GVB GVB vlerëson se shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes këshillimit akademik, studenti në FSHNH mund t'i drejtohet edhe Qendrës së Karrierës dhe Alumni, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë FSHNH-it/UNIKO-së. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht fokus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen.	

¹⁰⁹ Anex VIII. Dok. 8.14. <https://www.unkorce.edu.al/sq/drejtoria-e-burimeve-njer%C3%ABzore-komunikimit-dhe-promocionit>

¹¹⁰ Anex VIII. Dok. 8.15. www.unkorce.edu.al/sq/qendra-e-karrieres-dhe-alumni

¹¹¹ Anex VIII. Dok. 8.16. <https://www.unkorce.edu.al/sq/QKA>

¹¹² Anex VIII. Dok. 8.17. <https://www.unkorce.edu.al/sq/pun%C3%ABsime>

¹¹³ Anex VIII. Dok. 8.18. <https://www.unkorce.edu.al/sq/trajtime>

¹¹⁴ Anex VIII. Dok. 8.19. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/wus-prezantoi-bursat-sur-place-p%C3%ABr-student%C3%ABt-e-uniko>

¹¹⁵ Anex VIII. Dok. 8.20. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/4-student%C3%ABt-t%C3%AB-uniko-fites-t%C3%AB-bursave-sur-place-ofruar-nga-wus-p%C3%ABfunduan-me-sukses>

¹¹⁶ Anex VIII. Dok. 8.21. <https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/TE%20DHENA%20PER%20GJURMIMIN%20E%20STUDENTEV%20TE%20DIPLOMUAR%202017-2018.pdf>

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor në funksion të programeve të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individual ose për njësinë.

Misioni i UNIKO i përcaktuar edhe në statutin e tij e vë theksin në krijimin, transmetimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijeve me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Ky mision realizohet ndër të tjera edhe nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave, parimeve dhe procedurave të cilat mbikëqyrin procesin e mbështetjes financiare dhe logjistike që UNIKO ofron për njësitë e saj akademike dhe ndihmësakademike. Për këtë arsye, synimi kryesor i strukturave mbështetëse për kërkimin shkencor në UNIKO është përqendruar në ndërtimin e mekanizmave kërkimore institucionale të lidhur me programe të përcaktuara mirë, prioritetet të qarta dhe me ofrimin e shpërblimeve dhe vlerësimeve si nxitës për përfshirjen e stafit akademik në veprimtari kërkimore-zhvillimore cilësore, pa lënë mënjanë elemente të produktit shkencor, publikimet, partneritetet, marketingun kërkimor dhe ofrimin e shërbimeve për të tretë, për ta ngritur Kërkimin shkencor në UNIKO të përafërueshëm me standardet e përcaktuara në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor.

Theksi është vendosur gjithashtu edhe në nxitjen e hapjes shkencore përmes organizimit të veprimtarive periodike, konferencave shkencore, posterave promocionalë, duke rritur kërkimin ndërdisiplinor dhe bashkëpunues, si dhe duke ju përafëruar standardeve të cilësisë në rritjen e kulturës kërkimore për të shkuar drejt krijimit të qendrave kërkimore. Po kështu, një masë tjetër për realizimin e objektivave strategjikë është edhe ngritja e Qendrës së Inovacionit duke hedhur bazat për inovacionin shkencor, gjurmimin e ideve të reja, teknologjive bashkëkohore, spin-off me shtrirje të madhe dhe prirje për t'u lidhur me industrinë dhe marketingun kërkimor.

UNIKO dëshiron të përhapë mesazhin e rritjes akademike dhe cilësisë së kërkimit shkencor. Për realizimin e këtij misioni janë hartuar objektiva të cilët përcaktojnë synimet e UNIKO për mbështetjen e zhvillimit sistematik të veprimtarisë kërkimore-shkencore për periudhën 2019-2020.

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore në Universitetin e Korçës.

Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës për punë kërkimore-shkencore dhe për ofrimin e shërbimeve

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi dhe rajonalizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore duke nxitur cilësinë në kërkime.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Tregues të matshëm:

- ☒ Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit
- ☒ Dokumentacioni Përkates

Aktiviteti shkencor i stafit

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten produktet e stafit akademik të Fakultetit, në fushën e kërkimit shkencor për vitin akademik 2019-2020, të shpërndara sipas departamenteve.

Departamenti	Nr. i Artikujve		Konferenca Kombëtare	Konferenca Ndërkombëtare		Botime				Pjesëmarrje në Workshop, Seminar, Simpozium Kongres	Total
	Gjithsej	Me Faktor Impakti		Brenda Vendit	Jasthë vendit	Libra	Tekste mësimore	Dispenca	Monografi		
Matematikë, Informatikë dhe Fizikë	13	3	-	14	5	-	-	2	1	28	66
Shkenca Sociale	2	-	3	1	1	-	1	-	-	-	8
Biologji-Kimi	5	2	1	7	2	-	-	-	-	3	20
Infermieri											

Universiteti i Korçës bashkëpunon me universitete të njohura në mbarë botën përmes rrjeteve ndërkombëtare, platformave të bashkëpunimit si në aspektin e kërkimit dhe edukimit. Fushat e bashkëpunimit shtrihen në drejtim të:

- Njohuri dhe përvojës – brenchmarking
- Projekteve të përbashkëta
- Shkëmbimeve të ndërsjella - studentët dhe stafi
- Vendosjes së bashkëpunimit në projekte kërkimi e zhvillimi
- Forcimi i kontakteve në fushat e edukimit dhe kërkimit shkencor

Tregues të matshëm: ¹¹⁷

☒ Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

¹¹⁷ Anex VIII. Dok. 8.22. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> . Database e: [Bashkëpunimeve aktive](#) ; [Marrëveshjeve Kombëtare](#) ; [Marrëveshjeve Rajonale](#) ; [Marrëveshjeve Ndërkombëtare](#).

- ☒ Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programeve, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	FSHNH ka nxitur në vazhdimësi personelin akademik për të kontribuar në hartimin e programeve të reja që vlerësohen me interes për tregun e punës dhe zhvillimin e institucionit, si edhe për përmirësimin e programeve ekzistuese. Në departamente dhe më ngushtë në gruplëndë trajtohen në detaje çështjet e hartimit të programeve, të lëndëve, sigurimi i shmangies së mbivendosjes së temave në lëndë të përafërta ose të ngjashme, si dhe nga njëri cikël studimi në tjetrin. Çdo departament përcakton fushat prioritare të kërkimit.¹¹⁸
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj; Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë; Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit; Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	FSHNH në mënyrë institucionale si fakultet por edhe në kuadër të UNIKO për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët partnerë.^{119,120} Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit^{121, 122, 123}

¹¹⁸ Anex IX. Dok. 9.1. Dokumenti i përcaktimit nga departamentet i fushave të kërkimit.

¹¹⁹ Anex IX. Dok. 9.2. <https://www.unkorce.edu.al/sq/kerkimi-shkencor> . Database e: [Bashkëpunimeve aktive](#) ; [Marrëveshjeve Kombëtare](#) ; [Marrëveshjeve Rajonale](#) ; [Marrëveshjeve Ndërkombëtare](#).

¹²⁰ Anex IX. Dok. 9.3. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/uniko-p%C3%ABr-her%C3%AB-t%C3%AB-par%C3%AB-prezantohet-n%C3%AB-panairin-e-punes-2018-me-nj%C3%AB-ofert%C3%AB-t%C3%AB-re-akademie>

¹²¹ Anex IX. Dok. 9.4. <https://www.unkorce.edu.al/sq/content/rektori-i-uniko-prof-dr-ali-jashari-n%C3%ABnshkruan-marr%C3%ABveshjen-p%C3%ABr-projektin-nd%C3%ABr-komb%C3%ABtar->

¹²² Anex IX. Dok. 9.4. <http://172.16.0.2/sq/content/uniko-p%C3%ABr-her%C3%AB-t%C3%AB-par%C3%AB-prezantohet-n%C3%AB-panairin-e-punes-2018-me-nj%C3%AB-ofert%C3%AB-t%C3%AB-re-akademie>

¹²³ Anex IX. Dok. 9.5. <https://www.unkorce.edu.al/sq/trajnime>

Konkluzionet e GVB

GVB vëren se FSHNH ka krijuar lidhje të qëndrueshme me mjaft institucione të administratës publike që janë palë interesi për programet që ofron ky fakultet, për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre. Kë këtë kuadër, UNIKO zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës, pjesë e të cilit është dhe FSHNH, për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

ANALIZA SWOT

Pikat e forta të brendshme potenciale	Pikat e dobëta të brendshme potenciale
• Mjedise dhe infrastrukturë bashkëkohore për një zhvillim normal të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore në Fakultet. Infrastruktura në dispozicion të FSHNH është e mjaftueshme për të siguruar kushte të kënaqshme pune për studentët dhe pedagogët. Kushtet e mësimdhënies: ngrohje-ftohje-ventilim-ndriçim si dhe mjetet audiovizive, kompjuterat, videoprojektorët, tabelat, bankat, karriget etj, në mjaft auditorë janë konform me kërkesat bashkëkohore.	Gjatë punës së vlerësimit të brendshëm të FSHNH u konstatua se është e nevojshme përfshirja më e madhe e studentëve në aktivitetet akademike në njësi ose në nivel fakulteti. Gjithashtu, studentët duhet të ndërgjegjësohen për rolin që luajnë në sigurimin e cilësisë së veprimtarive akademike të fakultetit. Vërehet se ende nuk është gjetur pika e përbashkët ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies. Kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik, pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies.
• Stabiliteti strukturor i FSHNH. Nga pikëpamja e organizimit strukturor, të potencialeve njerëzore dhe të potencialeve drejtuese FSHNH ka njohur qëndrueshmëri të strukturave të saj si të njëjseve bazë dhe atyre administrative, ashtu edhe të organeve të saj kolegjiale. FSHNH dhe departamentet e saj plotësojnë kriteret e vendosura nga Ligji i Arsimit të Lartë për organizimin strukturor të një Institucioni të Arsimit të Lartë.	Cilat janë strategjitë e mundshme në përmirësimin e pikave të dobëta të evidentuara. (sugjerime)

- **Laboratorët** e kimisë, biologjisë, infermieristikës, fizikës, informatikës etj të pajisur me bazën e duhur laboratorike për zhvillimin e orëve të laboratoreve janë një pikë e fortë për realizimin e objektivave të procesit mësimor.
- Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në projekte. Lidhjet e Universitetit dhe FSHNH me universitete të tjera homologe në vende të Europës si Itali, Francë, Gjermani, Belgjikë, Vendet Nordike, Greqi, Maqedoni, etj ka mundësuar jo vetëm krijimin e kushteve për kualifikimin dhe shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik, por edhe bashkëpunim në drejtim të realizimit të programeve të studimit të cikleve të ndryshme.
- Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë. Cilësia e veprimtarisë së FSHNH garantohet nëpërmjet një sistemi të brendshëm, të përbërë nga strukturat organizative të Universitetit F. S. Noli dhe të Fakultetit. Ngritja e sistemit të sigurimit të cilësisë të përbërë nga Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në të gjitha nivelet (departament, fakultet dhe rektorat). Përpilimi i raporteve të vlerësimit të brendshëm për çdo vit akademik është kthyer në një metodë pune të përvitshme. Nëpërmjet këtij sistemi dalin në pah dobësitë, të metat, vështirësitë, por edhe arritjet, sukseset dhe përmirësimet e vazhdueshme që realizohen vit pas viti.
- Format demokratike të zgjedhjes të organeve kolegjiale dhe drejtuesve të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, forcimi i organeve kolegjiale, si dhe ndërgjegjësimi gjithnjë e më shumë për të sjellë në krye të drejtimit njerëzit me programet më të mira për zhvillimin e njësisë është një pikë e fortë që garanton një udhëheqje sa më kolegjiale të njësisë.
- Përfshirja e studentëve në vendim-marrje. Organizimi i studentëve nëpër Këshillat studentore, përfaqësimi i tyre në të gjitha organet kolegjiale, përfshirja e studentëve në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, organizimi i aktiviteteve të ndryshme studentore që nga seminare shkencore deri në aktivitete sportive, bashkëpunimi i vazhdueshëm i drejtuesve të FIM me këshillin studentor, etj janë procese të cilat rriten e përmirësohen vazhdimisht duke ndikuar në forcimin e zërit të studentëve dhe rritjen e rolit të tyre aktiv në procesin e vendimmarrjes.
- Organizimi i studimeve në FSHNH (cikli i parë,

Gjatë punës së vlerësimit të brendshëm të FSHNH u konstatua se është e nevojshme përgatitja dhe zbatimi i një strategji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuar si prioritete

Ndërmarrja e një projekti që do të ndihmojë në digjitalizimin e bibliotekës së universitetit dhe krijimin e bibliotekës online.

Konsolidimi i programeve ekzistuese në ciklin BACHELOR dhe MASTER duke e përmirësuar kurrikulën ekzistuese dhe njehësuar atë me kurrikulat e universiteteve të tjera brenda vendit dhe në rajon;

Lidhje funksionale dhe shkëmbimeve akademike me institucione simotra që ofrojnë programe dhe shërbime të ngjashme

cikli i dytë) është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë, duke përgatitur specialistë me kualifikime të ndryshme në fushat dhe programet tona, nga niveli Bachelor deri në nivelin e Masterit shkencor duke rritur mundësitë e realizimit të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik, lehtëson kushtet e njohjes së diplomave tona në vendet e Bashkimit Europian dhe krijon të gjitha shanset e bashkëpunimit me Universitete partnere për realizimin e ciklit të tretë të studimeve si dhe një pjesë të ciklit të dytë.

- Krijimi i qendrës së Ekselencës si njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese. Në FSHNH funksionon edhe Qendra e Ekselencës, e cila përbën një njësi bazë, kërkimore dhe trajnuese. Kjo qendër ka si mision të vetin, formimin cilësor të specialistëve në fushat përkatëse dhe promovimin e kërkimit shkencor në shkencat e natyrës dhe ato humane. Ajo funksionon si njësi trajnuese dhe kërkimore në fushën e Didaktikës së Shkencave, e çertifikuar dhe akredituar nga MASH.
- Përfshirja intensive e stafit në kualifikimet pasuniversitare. Stafi akademik i FSHNH është përfshirë intensivisht në kualifikime pasuniversitare, gati 47% e stafit akademik janë në proces doktorature duke krijuar vazhdimësi dhe qëndrueshmëri në cilësinë e stafit mësimdhënës.
- Programe në përputhje me nevojat rajonale, kërkesës së tregut dhe më gjerë. FSHNH ofron programe bashkëkohore dhe të kërkuara nga tregu rajonal, kombëtar dhe më gjerë. Programet e ofruara krijojnë mundësi për afrimin e studentëve nga gjithë rajoni juglindor i vendit por dhe më gjerë. Kjo vihet re në plotësimin e kuotave për regjistrim dhe në shtimin e kërkesës për shkollim.
- Aplikimi i filozofisë interaktive të arsimit të lartë dhe aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies. Në FSHNH aplikohet filozofia interaktive e arsimit të lartë ku në qendër të sistemit vendoset studenti i cili punon mbi bazën e objektivave dhe është aktiv gjatë zhvillimit të procesit mësimor, i cili zhvillohet nëpërmjet metodave të reja të mësimdhënies kryesisht audiovizuale dhe pedagogjike interaktive që nxitin punën e pavarur dhe formimin (vlerësimi formues) e studentit.
- Pozicioni gjeografik i Universitetit F. S. Noli dhe FSHNH. Vendndodhja gjeografike e Universitetit F. S. Noli si qendër universitare për gjithë rajonin juglindor të Shqipërisë dhe në kufi me dy shtete ballkanike ofron mundësi për

përthithjen e studentëve të rajonit dhe më gjerë si dhe për shkëmbim përvojash në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor. • Mosha e re e stafit akademik. Duke qenë se mosha mesatare e stafit akademik është 38 vjeç, krijohen mundësi për kualifikime të mëtejshme. • Misioni dhe objektivat e Fakultetit janë objektivë, në përshtatje me kapacitetet e fakultetit dhe të realizueshme. Stafi akademik njeh dhe punon në drejtim të realizimit të tyre dhe informon rregullisht studentët dhe përfaqesuesit e tyre mbi arritjet dhe ndryshimet (përmirësimet) në këtë drejtim. • Lidhja me internet në çdo ambjent zyre dhe për çdo anëtar të stafit të Fakultetit, krijimi i regjistrit elektronik për studentët, informimi i tyre në kohë reale elektronike mbi objektivat, programet e lëndëve, rezultatet në provime ka krijuar kushte për përmirësimin e urave të komunikimit ndërmjet niveleve të ndryshme të strukturave të Fakultetit si dhe midis pedagogëve dhe studentëve.	
Mundësitë e jashtme potenciale	Rreziqet e jashtme potenciale
1. Një pjesë e dobësive të konstatuara që kanë lidhje me punën e stafit akademik dhe me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në Fakultet janë plotësisht të menaxhueshme nëpërmjet vendosjes të prioritetëve dhe me gatishmërinë e organeve drejtuese të Fakultetit dhe Universitetit. Duke parë ndryshimet dhe përmirësimet e bëra si në infrastrukturë ashtu edhe në mënyrën e menaxhimit dhe drejtimit të institucionit, themi se stafi akademik dhe organet drejtuese kanë kualifikimet dhe eksperiencën për të bërë përmirësimet përkatëse aty ku vihen re pika të dobëta.	• Unifikimi i kurrikulave të programeve të njëjta ose të përafërta me fakultete të tjera • Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit
2. Politikat e ndjekura nga qeveria për plotësimin e universiteteve me stafit akademik efektiv është në përputhje me nevojat tona për staf të ri akademik. Është në dorë të drejtimit që të gjurmojë dhe të përzgjedhë kandidaturat më të mira nga ana cilësore si dhe në moshë relativisht të re.	Strategji të shmangies së rreziqeve të jashtme potenciale

3. Kuadri ligjor aktual për arsimin e lartë, krijon mundësi për forcimin e demokracisë në jetën universitare, për ndarjen sa më mirë të përgjegjësi, rritjen e përgjegjshmërisë së organeve drejtuese të institucionit në menaxhimin e burimeve njerezore, materiale e financiare të institucionit.
 4. Marrëdhëniet e ngushta me institucionet arsimore qendrore dhe lokale në funksion të realizimit të kualifikimeve të synuara.
 5. Zbatimi në praktikë e autonomisë financiare, e cila duhet të shtrihet deri në nivel departamenti, krijimi i rregullave të brendshme për mënyrën e menaxhimit dhe të kontrollit të shpenzimeve, do të rrisë më shumë autonominë e njësi duke përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, aktivitetin shkencor dhe laboratorët mësimor e shkencor të Fakultetit.
 6. Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijes, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm.
 7. Proçeset integruese, projektet e përbashkëta në të cilat është përfshirë Universiteti ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione brenda e jashtë rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor. Pjesëmarrja në to e sa më shumë anëtarëve të stafit akademik dhe drejtues synon përmirësimin e cilësisë, kualifikimin e vazhduar dhe shkëmbimin e eksperiencave pozitive reciproke.
 8. Kualifikimi i vazhduar i stafit akademik mbi metodologjinë e projekteve, gjuhën e huaj, teknologjinë e informacionit, metodikën e mësimdhënies ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së brendshme si dhe veprimtarisë akademike kërkimore, shkencore dhe mësimore të programeve të studimit.
 9. Promovimi i aktivitetit kërkimor në nivel departamenti mund të përmirësohet:
 - Njëpërmjet organizimit të konferencave, simpoziumeve dhe seminareve
 - Njëpërmjet pjesëmarrjes së departamentit në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare:
 - Njëpërmjet realizimit të botimeve për pedagogët në fazë doktrale dhe mbrojtje të titullit akademik:
 - Njëpërmjet bashkëpunimit me institucionet
- Dalja e kuadrit ligjor për të bërë realitet unifikimin e kurrikulave të programeve të mësuesisë në masën 80%
 - Bashkëpunimet me institucionet e tjera (fakultete/ institute/qendra kërkimi) të mos mbeten vetëm në kuadër të marrëveshjeve.
 - Mungesa e literaturës bashkëkohore në bibliotekë dhe mosshfrytëzimi i literaturës ekzistuese nga studentët në shkallën e duhur.
 - Përqindje e ulët e punësimit të të diplomuarve në pjesën më të madhe të programeve të studimit të ofruara nga FSHNH, për shkak të papunësisë në rritje. (me përjashtim të programeve Matematikë – Informatikë, Matematikë-Fizikë dhe Biologji – Kimi, ku përqindja e të punësuarve është mjaft e lartë)
 - Duhet të vazhdojë puna e nisur për përmirësimin e kurrikulave, duke i lidhur më tepër me kërkesat e tregut të punës dhe pajisjen e studentëve me kompetenca.
 - Duhet të realizohet rritja e cilësisë së mësimdhënies duke shfrytëzuar më mirë bazën materiale dhe didaktike në dispozicion të stafit dhe studentëve.
 - Labororet funksionale të Fizikës, Biologji-Kimisë dhe Labororet në përdorim të Departamentit të Infermierisë, vazhdojnë të jenë një pikë e fortë e Fakultetit, që ndikon fuqishëm në një formim akademik më të mirë të studentëve si dhe në dobi të veprimtarisë kërkimore.
 - Duhet të synohet më tepër në rritjen e mëtejshme të produktivitetit të metodave të të nxënies si dhe zhvillimi më i mirë dhe i kontrolluar i praktikave profesionale.
 - Të aplikohen rezultatet e përfuara nga studimi i tregut i kryer nga disa departamente, për përmirësimin e kurrikulave, ristrukturimin e programeve ekzistuese apo të kryhet aplikimi për çeljen e programeve të reja të studimit.
 - Strategjitë e ndjekura nga disa departamente, kanë çuar në përmirësimin e raportit staf-student krahasuar me vitet e mëparshme.
 - Të përpilohen strategji nga departamentet për të përfshirë studentët në veprimtari të ndryshme kulturore, sociale dhe shkencore, për të shmangur praninë e pakët të këtyre lloj aktiviteteve në pjesën më të madhe të departamenteve.
 - Zhvillimi i infrastrukturës, bibliotekës dhe mjediseve për të mbështetur procesin akademik si dhe për të gjallëruar jetën studentore.
 - Të rritet bashkëpunimi, aplikimi dhe pjesëmarrja në Projekte Kombëtare dhe Ndërkombëtare nga ana e

rajonale lokale e më gjerë. 10. Ngritja e Qendrës së Karrierës në Universitet do të përmirësojë lidhjet e institucionit me studentët, do të krijojë kushtet për ngritjen e një databaze për studentët dhe për punësimin e tyre, për formimin e vazhduar etj.	departamenteve, duke nxitur trajnimin dhe rritur nivelin e ekspertizës së aplikimeve. • Hartimi i strategjive nga ana e departamenteve për përthithjen e studentëve cilësorë. • Thellimi i mëtejshëm i punës organizative të departamenteve mbi bazën e kërkesave që ka aktiviteti kërkimor. • Rritja e mëtejshme e kualifikimeve të stafit akademik. • Angazhim më i madh i stafit akademik në aktivitete shkencore dhe botuese. Të nxitet dhe përkrahet stafi në hartimin e teksteve mësimore për studentët. • Vazhdimësi në thellimin e punës kërkimore me studentët nëpërmjet komunikimit të rezultateve të kërkimit në Fakultet si dhe të trajnimit të tyre me konceptet dhe parimet e etikës në kërkim. • Intensifikim i punës kërkimore dhe kualifikuese të stafit akademik, nëpërmjet projekteve të kërkimit në kuadër të doktoraturës, botimeve të artikujve shkencorë në organe me autoritet shkencor si dhe pjesëmarrjes në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. • Përkrahja e nismave të departamenteve për zhvillimin e aktiviteteve shkencore në Fakultet. • Të rritet organizimi i seminareve, simpoziumeve apo ëorkshop nga departamentet, ku të krijohet mundësia dhe e paraqitjes së punimeve më të mira nga studentët e Fakultetit. • Mbështetja e kërkuesve të rinj, duke shfrytëzuar të gjithë hapësirën ligjore në dispozicion dhe kapacitetet e brendshme akademike për t'i përfshirë në programet kërkimore të departamenteve. • Duhet më shumë bashkëpunim në nivel lokal dhe kombëtar me institucionet përkatëse, me qëllim punësimin e studentëve më cilësorë. • Mungesa e një databaze për punësimin e studentëve të diplomuar në vite. • Mungesa e një mjedisi të përshtatshëm sportiv në Fakultet. • Mungesa e autonomisë financiare për Fakultetin dhe Departamentin. • Duhet të përmiresohen instrumentat dhe metodat e vlerësimit të studentëve. • Duhet të përmirësohet në vazhdimësi cilësia e programeve, e mësimdhënies dhe e formimit të studentëve.
--	--

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

Maria Dojçe

Blendi Baze

Blerina Çeliku

Desareda Mero

Katerina Sotir